REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

# RAPORT MONITORIMI
# JANAR – DHJETOR 2018

# STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË 2017 – 2020

www.drejtesia.gov.al

## Tabela e Përmbajtjes


I. Përmbledhje ekzekutive mbi monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017-2020 dhe Planit të Veprimit për periudhën Janar – Dhjetor 2018. .......... 4

a. Përmbledhje ekzekutive mbi reformën e sistemit të drejtësisë .......... 6

II. Metodologjia e monitorimit .......... 12

III. Disbursimi financiar .......... 13

IV. Progresi i zbatimit sipas objektivave .......... 15

Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë. .......... 15

Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave. .......... 16

Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasistetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane. .......... 18

Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale. .......... 19

Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar. .......... 20

Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit. .......... 21

Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara. .......... 22

Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin. .......... 23

V. Arritjet kryesore gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018.......... 24

VI. Analizë krahasimore lidhur me ecurinë e Planit të Veprimit për vitin 2017 dhe vitin 2018.......27

VII. Nevoja për rishikim të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.......... 29

VIII. Konkluzione .......... 29

IX.Sfidat.......... 30

Aneks 1 – Progresi lidhur me paketën e 27 ligjeve të reformës në drejtësi .......... 31

Aneks 2 – Plani i Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.......... 33

## LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---|---|
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| ALBIS | Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor |
| AP | Avokati i Popullit |
| ASHSGJ | Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor |
| DPB | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| DPP | Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit |
| DHKA | Dhoma Kombëtare e Avokatisë |
| DHKN | Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve |
| DHKPGJP | Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privat |
| GJK | Gjykata Kushtetuese |
| GJL | Gjykata e Lartë |
| ILD | Inspektori i Lartë i Drejtësisë |
| IML | Instituti i Mjekësisë Ligjore |
| KED | Këshilli i Emërimeve në Drejtësi |
| KLD | Këshilli i Lartë i Drejtësisë |
| KLGJ | Këshilli i Lartë Gjyqësor |
| KLP | Këshilli i Lartë i Prokurorisë |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KSHB | Komiteti Shqiptar i Birësimeve |
| KSHNJ | Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomise |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| PV | Plani i Veprimit |
| QPZ | Qendra e Publikimeve Zyrtare |
| SND | Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017-2020 |
| SPAK | Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion |
| SHM | Shkolla e Magjistraturës |
| SHP | Shërbimi i Provës |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| ZABGJ | Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË 2017-2020 DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2018.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017-2020 dhe Plani i saj i Veprimit është miratuar nga Këshilli i Ministrave, me Vendimin 773, datë 02/11/2016.

**Misioni** i kësaj strategjie është zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane.

Strategjia ka *tetë objektiva strategjike të nivelit të lartë*, të cilat janë:

1. Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
2. Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.
3. Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
4. Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
5. Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
6. Shtimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin ndëshkimor.
7. Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj vartëse.
8. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017 - 2020 dhe përbën raportin e katërt të monitorimit. Raporti mbulon progresin gjatë periudhës 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018. Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin apo/dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë, nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacioni nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e SND-së.

*Plani i Veprimit përbëhet nga 8 objektivat e mësipërme dhe përmban në total 201 nën-aktivitete*[1]. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të nën-aktiviteteve, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektivi. Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të nën-aktiviteteve të SND-s bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse. Ministria e Drejtësisë ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë muajit shkurt 2019. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për periudhën janar - dhjetor 2018, rezulton se niveli i zbatimit të masave të Planit të Veprimit është si më poshtë:

[1] Nën-aktiviteti 3.01.c "Regjistrimi i Domain" me institucion përgjegjës Kuvendin, të parashikuar në PV të SND-së, nuk është përfshirë në numërim/analizë pasi ky nën-aktivitet nuk i përgjigjet nevojave të institucionit dhe për këtë arsye duhet të rishikohet "institucioni përgjegjës".

Statusi i realizimit të nën-aktiviteteve sipas Objektivave




Progresi kundrejt secilit objektiv




***Deri më tani nga 201 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë realizuar 74 prej tyre, 31 janë ende në proces zbatimi dhe 96 nën-aktivitete të parealizuara (nga të cilat 65 nën-aktivitete janë nën fushën e përgjegjësisë së institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë).*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit është në nivelin 37% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 15% për nën-aktivitetet në proces, 48% për nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

## a. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI REFORMËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

- *Progresi në Legjislacion*

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri i është nënshtruar së fundmi një sërë reformash të thella, në funksion të përmbushjes së standarteve evropiane në këtë sistem. Përmes miratimit të Ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Shqipëria filloi zbatimin e reformës në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në kuadrin e reformës së drejtësisë përmbajnë dispozita të përcaktuara qartë që garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të saj. Për më tepër, një paketë prej 27 ligjesh është planifikuar të miratohet, duke mbuluar të gjitha aspektet e reformës gjyqësore, ku deri më tani Kuvendi ka miratuar 19 prej tyre[2].

**Në muajin maj 2018**, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 26/2018 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.* Ligji përcakton qartësisht: a) parimet e përgjithshme të ndërmjetësimit; b) mosmarrëveshjet ku mund të aplikohet ndërmjetësimi; ç) organizimin dhe funksionimin e organeve të parashikuara nga ky ligj; d) të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve".

Gjithashtu, ligji përcakton edhe detyrat e Ministrit të Drejtësisë, i cili ushtron fuksionet e mëposhtme: a) jep licencën e ndërmjetësit; b) fillon procedimin disiplinor, sipas shkronjës "b", të nenit 11/3, të këtij ligji, si dhe vendos në lidhje me masën disiplinore për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit; c) kontrollon, nëpërmjet strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, zbatimin e këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me veprimtarinë e ndërmjetësve; ç) miraton rregullat dhe procedurat për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në një shtet të huaj.".

**Në muajin korrik 2018,** Kuvendi miratoi Ligjin nr. 55/2018 *"Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë".* Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe garantimin e ushtrimit të profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë, si një profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar në funksion të mbrojtjes së interesave individualë dhe kolektivë të subjekteve që ai përfaqëson.

**Në muajin nëntor 2018,** Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 80/2018 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar".* Risitë e sjella nga ky ligj konsistojnë në: a) Parashikimin e garancive të lidhura me njoftimin e të miturit të dënuar, duke e harmonizuar me parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit; b) Saktësimin e procedurës së ekzekutimit të vendimeve penale që përmbajnë detyrim civil, duke e harmonizuar me terminologjinë e përdorur në Kodin e Procedurës Penale, por edhe me qëllim që të shmangen zvarritjet në procesin e ekzekutimit në rastin kur palë e dëmtuar është shteti. c) Reflektimin e ndryshime të miratuara së fundmi në Kodin Penal në dispozitën që parashikon rastet e vendimeve që ekzekutohen menjehërë, siç është rasti i pezullimit të dënimit me burgim dhe vënia në mbikqyrje të shërbimit të provës si dhe qartësimin e rregullave lidhur me mënyrën e zbatimit të urdhërimit të gjykatës për lirimin e menjershëm duke parashikuar në mënyrë

[2] Më tepër informacion mbi paketën e 27 ligjeve është pasqyruar në aneksin 1 të këtij raporti.

të qartë përgjegjësitë e prokurorit si dhe të institucionit të ekzekutimit të vendimit penal. d) Përmirësimin e procedurës së ekzekutimit të vendimeve të gjykatës, për rastet e nxjerrjes jashtë territorit të personave të të huaj dhe pa shtetësi.

**Në muajin nëntor 2018,** Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.86/2018 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018/2008 "Për avokaturën e shtetit".* Risitë e sjella nga ky ligj konsistojnë në: a) Saktësimin e rolit të Avokaturës së Shtetit si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nëpërmjet agjentit qeveritar dhe bashkëagjentëve; b) Ngritjen e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, si organ kolegjial pranë Avokaturës së Shtetit, i cili jep këshilla për çështje të një rëndësisë të vaçantë për interesat e shtetit dhe miraton stategjinë e mbrojtjes për këto raste si dhe jep udhëzime për bashkërendimin e çështjeve në kuadër të dhënies së asistencës juridike; c) Përcaktimin e saktë të rasteve të detyrueshme për këshillim paraprak të organit të administratës publike me Avokaturën e Shtetit, i cili synon reduktimin apo eleminimin e dëmeve financiare si pasojë e marrdhënieve kontraktuale nga njëra anë si dhe unifikimin e praktikës administrative në këtë drejtim; d) Harmonizimin e parashikimeve të këtij projektligjit me ligjin nr. 98/2017 "*Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë*", lidhur me të drejtën e avokaturës së shtetit për t`u përjashtuar jo vetëm nga tarifat gjyqësore por edhe nga shpenzimet gjyqësore; e) Parashikimin e një Kreu të veçantë që detajon procedurën e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke saktësuar rolin e Avokaturës së Shtetit, veprimet që duhet të kryhen nga cdo institucion përgjegjës për ekzekutimin, afatet procedurale të bashkëpunimit ndërinstitucional, dhe rolin monitorues të Kuvendit, me qëlllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga KEDNJ për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës në përputhje me afatet e caktuara prej saj.

- *Organet e Qeversisjes së Sistemit të Drejtësisë*

Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në përcaktimet institucionale të gjyqësorit shqiptar. Institucionet ekzistuese janë modifikuar dhe institucione të reja janë krijuar nga amendamentet kushtetuese dhe ligjet specifike organike të lartpërmendura.

Ministria e Drejtësisë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016, datë 06.10.2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" *nuk ushtron më kompetencën e kontrollit të veprimtarisë së prokurorive dhe gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe të dhënies së rekomandimeve për procedim disiplinor në rastin e prokurorëve dhe procedimin disiplinor në rastin e gjyqtarëve.* Nga hyrja në fuqi e këtij ligji (22.11.2016), çdo ankesë apo informacion, që nga verifikimi paraprak rezulton se ka indicie të besueshme për shkelje disiplinore nga ana e magjistratit, i përcillet për verifikim dhe ndjekje të mëtejshme të procedurave KLD-së apo/dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Institucionet e krijuara rishtazi dhe ato që parashikohen të ngrihen janë si në vijim:
- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016[3].
- Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.

[3] http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_nr_115_2016_per_organet_e_qeverisjes_se_sistemit_te_drejtesise_1726.pdf

- Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) – Kushtetuta dhe ligji nr. 115/2016.
- Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar – Kushtetuta dhe ligji nr. 95/2016[4].
- Njësia e Posaçme Hetimore/Byroja Kombëtare e Hetimit – Kushtetuta dhe ligji nr. 95/2016.
- Gjykata kundër korrupsionit dhe Krimit të Organizuar – Kushtetuta dhe Ligji nr. 98/2016.
- Këshillat e Gjykatave – Ligji nr. 98/2016[5].
- Institucionet Ri-vlerësuese – Ligji nr. 84/2016[6].

Përsa i përket institucioneve të krijuara rishtazi, një hap vendimtar në zbatimin e reformës në drejtësi shënoi ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat janë 2 shtyllat për një sistem gjyqësor të pavarur dhe cilësor.

Më datë **11 dhjetor 2018**, u mbajt Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të **Këshillit të Lartë të Prokurorisë**. Në fund të procesit të votimit u përzgjodhën 6 prokurorë, si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbajti takimin e parë më datë **19 dhjetor 2018**, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i themeluar tashmë, është autoriteti kompetent për emërimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Më datë **12 dhjetor 2018**, u organizua Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të **Këshillit të Lartë Gjyqësor**. Në fund të procesit të votimit u përzgjodhën 6 gjyqtarë, si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajti takimin e parë më datë **20 dhjetor 2018**, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit. Në mbledhjen e datës 22 dhjetor 2018, KLGJ, duke pasur parasysh rëndësinë e zgjedhjes së nënkryetarëve të gjykatave dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në kushtet kur gjykata mbetet pa kryetar, hapi rrugën duke miratuar rregullat për zgjedhjen e nënkryetarëve të gjykatave. Për më tepër, në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj, Këshilli vendosi të iniciojë procedurën për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatat Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke hapur rrugën për krijimin e këtyre gjykatave.

**Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,** në zbatim të nenit 149/d të Kushtetutës, kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, si dhe kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, midis radhëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ata ushtrojnë mandatin e tyre për një vit.

Më datë **7 dhjetor 2018,** Kryetari i Kuvendit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d të Kushtetutës, nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe Urdhrit nr. 2, datë 3.12.2018, të Kryetarit të Kuvendit "Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi", zhvilloi procedurën e

[4] https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/10/ligj-nr-95-dt-6-10-2016.pdf
[5] http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/209-2016.pdf
[6] http:/www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/VETINGU/ligj-nr-84-dt-30-8-2016.pdf

hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm). Në përfundim të hedhjes së shortit, u emëruan 8 anëtarë të Këshillit të Emërimit të Drejtësisë, si dhe tre anëtarë zëvendësues. Një nga anëtarët e KED, konkretisht Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, u shkarkua nga detyra me një vendim përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Rrjedhimisht, KED për vitin 2019 ka vetëm 7 anëtarë dhe tre anëtarë zëvendësues.
**Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,** i emëruar sipas këtij shorti, ushtron funksionin e tij për një vit kalendarik duke filluar nga data 1 janar 2019.

- *<u>Zhvillimet kryesore mbi krijimin e institucioneve ri-vlerësuese</u>*

Komisioni i Pavarur i Kualikimit është organ i ri kushtetues, me mandat 5-vjeçar, i krijuar me ndryshimet e reja të Kushtetutës, si pjesë e paketës për Reformën në Drejtësi, për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni. Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 82/2017, datë 17.6.2017, miratoi në bllok listën me 12 komisionerë. Veprimtaria e Komisionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i ligjit është rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve (subjekteve të rivlerësimit) në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni vlerëson çështjet e subjekteve të rivlerësimit në 4 trupa gjykuese me 3 anëtarë secila, bazuar në tre kritere:

a) Vlerësimi i pasurisë;
b) Vlerësimi i figurës;
c) Vlerësimi i aftësive profesionale.

Këshilli i Ministrave, me Vendimet nr. 518, datë 20.09.2017 dhe nr. 497, datë 13.09.2017 ka kaluar në përgjegjësi administrimi/përdorim të përkohshëm godinat ku do të ushtrojnë veprimtarinë organet e rivlerësimit kalimtar. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 574, datë 09.10.2017 ka përcaktuar pagesën mujore shtesë për shkak të vështirësisë, për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit.

Bazuar në Vendimet nr. 92/2017, 93/2017 dhe 94/2017, Kuvendi ka miratuar strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ("KA"), Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ("KPK") dhe Komisionerëve Publik ("KP").

Me Vendimin Nr. 767 datë 20.12.2017 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 518 datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posacëm të Apelimit, institucioni i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar nga Ligji Nr.84/2016", Ministrisë së Drejtësisë i kaloi në përgjegjësi administrimi i gjithë kati ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit me qëllim akomodimin e Kolegjit të Posacëm të Apelit.

Me VKM Nr. 46 datë 31.01.2018 "Për disa ndryshime në Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.518 datë 20.09.2017 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës ku ushtron veprimtarinë Kontrolli i Lartë i Shtetit, për Kolegjin e Posacëm të Apelimit, Institucioni i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i parashikuar

nga Ligji Nr.84/2016, të ndryshuar, dhe Nr. 497 datë 13.09.2017, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të ish-godinës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, nga Ministria e Kulturës Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të parashikuar nga ligji Nr.84/2016, Komisioneri Publik është vendosur në një pjesë të katit të dytë ku ushtronte veprimtarinë KLSH-ja.

Ministria e Drejtësisë me fondet e buxhetit të vitit 2018 ka realizuar rikonstruksionin e plotë të të gjitha zyrave të katit të dytë për akomodimin e Kolegjit të Apelit dhe Komisionerit Publik. Vlera e rikonstruksionit për këto ambiente është **110.593.408 lekë.**

Përveç rikonstruksionit të plotë të zyrave, me fondet e buxhetit të vitit 2017, është realizuar edhe mobilimi i të gjitha ambienteve, përfshirë pajisjet e teknologjisë së informacionit. Vlera e pajisjeve të mobilimit, si dhe të pajisjeve të teknologjisë së informacionit është **41.214.840 lekë**.

Me fondet buxhetore të vitit 2018, Ministria e Drejtësisë ka realizuar edhe rikonstruksionin e hyrjes kryesore të Kolegjit të Apelit dhe Komisionerit Publik me vlerë totale 9,6 milion Lekë. Objekti i ambienteve të Kolegjit të Apelit – Vetting *ka përfunduar plotësisht* dhe është vënë në shfrytëzim në muajin qershor 2018.

- *<u>Procesi i vlerësimit dhe ecuria e institucioneve ri-vlerësuese</u>*

Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Apelimit, Institucioni i Komisionerëve Publikë, në bashkëpunim me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit.

Në datën **15 janar 2018** u zhvillua shorti për shpërndarjen e çështjeve në trupat gjykuese. Pjesë e kësaj liste janë kryetarët e gjykatave, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, gjyqtarët e Gjykatave të Apelit; në total **36 subjekte rivlerësimi,** për të cilët nisi menjëherë procedura e rivlerësimit.

Në datën **15 mars 2018** u zhvillua shorti i radhës për shpërndarjen e çështjeve në trupat gjykuese. Pjesë e kësaj liste janë kryetarët e gjykatave të rretheve dhe drejtuesit e prokurorive të rretheve; në total **36 subjekte rivlerësimi**, për të cilët nisi menjëherë procedura e rivlerësimit.

Numri i përgjithshëm i vendimeve të dhëna nga Komisioni për periudhën janar – dhjetor 2018 është **<u>92 vendime</u>**:

- ✓ 42 vendime për konfirmimin në detyrë të 20 gjyqtarëve, 18 prokurorëve 4 ndihmësve ligjorë/ kandidatë për magjistratë
- ✓ 35 vendime për shkarkimin nga detyra të 22 gjyqtarëve dhe 12 prokurorëve dhe 1 ndihmësi ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë/kandidat për magjistrat
- ✓ 7 vendime për ndërprerjen e procesit për 4 gjyqtarë dhe 2 prokurorë, 1 ish-këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese;
- ✓ 8 vendime për pushimin e procesit për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë.

**Kolegji i Posaçëm i Apelimit** vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Aktualisht, për periudhën janar – 31 dhjetor 2018 janë regjistruar 40 **(dyzetë)** çështje të juridiksionit të rivlerësimit, nga të cilat **12 (dymbëdhjetë**) kanë përfunduar, **3 (tre)** janë nën gjykim dhe **25 (njëzetepesë**) janë në përgatitje për gjykim. Nga çështjet të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vendosur:

i. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – **në 8 vendime**;
ii. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me përmbajtjen në dispozitiv për ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare – **në 2 vendime**;
iii. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit – **në 1 vendim**.
iv. Pushimin e shqyrtimit të çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit nga ankuesi – **në 1 vendim**.

Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve është parashikuar në nenin 53 të ligjit nr.84/2016, sipas të cilit çdo person që është në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejte institucionet e rivlerësimit. Në këtë kuadër, deri më 31 dhjetor 2018, në regjistrin e denoncimeve të publikut të KPA-së janë regjistruar 136 denoncime. Denoncuesit kanë marrë përgjigje zyrtare lidhur me ankimet e përcjella pranë Kolegjit.

Në përgjigje të nevojave të institucionit, si dhe bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", i ndryshuar me vendimin nr.101/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", po vijon procesi i rekrutimit për të plotësuar vendet vakante dhe shtesat në strukturë.

Institucioni i **Komisionerëve Publikë** si përfaqësues i interesit publik gjatë procesit të Reformës në Drejtësi, ushtron këto kompetenca*:*

a. Ankimon në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 15 ditë pas njoftimit (neni 63 i ligjit nr. 84/2016).
b. Përgatit raportin me shkrim me arsyet e refuzimit për moszbatimin e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për të paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (aneksi kushtetues, neni B "Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit).
c. Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i ligjit nr. 84/2016).

**Institucioni i Komisionerëve Publikë**, për periudhën janar - dhjetor 2018, është njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për **77 vendime**. 16 prej tyre janë ankimuar (*1 heqje dorë nga ankimi*) dhe për 57 vendime është vendosur mosankim. Në proces shqyrtimi janë 4 vendime të KPK-së.

Në regjistrin e denoncimeve të publikut, për periudhën janar-dhjetor 2018, janë regjistruar **71 denoncime**.

**Aktet nënligjore dhe normative të miratuara nga Mbledhja e Komisionerëve Publikë.**

- Rregullorja "Për veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë";
- Rregullore e brendshme administrative e Institucionit të Komisionerëve Publikë;
- Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionerëve Publikë;
- Rregullore "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Institucionin e Komisionerëve Publikë";
- Rregullore për median.

**Ministria e Drejtësisë** ka lehtësuar procesin e rivlerësimit në tre drejtime kryesore:

- Duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për organet e rivlerësimit;
- Duke siguruar mjetet financiare për organet e rivlerësimit;
- Duke bashkëpunuar me organet e vetingut mbi kërkesat për informacion të paraqitura në kuadër të procesit të rivlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit që po kryhen nga këto organe.

## II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 166, dt. 5.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë," pranë Ministrisë së Drejtësisë është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive.

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën nga *1 janar 2018 deri në 31 dhjetor 2018* dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit të SND-së**.** Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Çdo institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo politike dhe aktiviteti, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të nën-aktiviteteve, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektivi. Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht online, për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, për të siguruar

saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura. Për më tepër, ky raport monitorimi shërben për të vlerësuar ecurinë e Strategjisë prej një harku kohor 2-vjeçar, nëpërmjet analizimit dhe krahasimit të implementimit të Planit të Veprimit respektivisht për vitin 2017 dhe vitin 2018.

*Pas hartimit të draft raportit*, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikon draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft-raportin e monitorimit para se të miratohet nga Mekanizmi Institucional i Monitorimit.

## III. DISBURSIMI FINANCIAR

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për vitin 2017 - 2021 për Reformën e Sektorit të Drejtësisë është vlerësuar në 98,385,653 Euro. Në momentin e hartimit të planit të veprimit hendeku financiar është vlerësuar të jetë në masën 35% të totalit. Meqenëse hendeku financiar apo edhe kosto e përgjithshme e PV 2017-2021 nuk është rishikuar që prej aprovimit të Strategjisë, statistikat financiare të raportuara në vijim i referohen kostove të parashikuara në momentin e miratimit të planit të veprimit.

Kostoja e përgjithshme për zbatimin e Planit të Veprimit për vitin 2017-2021 për Reformën e Sektorit të Drejtësisë shpërndahen si më poshtë mbi llojet e shpenzimeve dhe viteve:

| Kategoria | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Totali | % e totalit të përgjithshëm |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kapitale | 6.666.978 | 14.425.000 | 9.836.000 | 5.240.000 | 3.619.922 | 39.787.900 | 40,44% |
| Pagat | 5.286.060 | 5.346.060 | 12.066.260 | 12.106.260 | 12.106.260 | 46.910.900 | 47,68% |
| Trajnime | 885.000 | 260.000 | 310.000 | 222.000 | 195.000 | 1.872.000 | 1,90% |
| Shpenz. tjera aktuale | 1.919.713 | 707.285 | 2.172.285 | 2.590.285 | 2.425.285 | 9.814.853 | 9,98% |
| **Totali i Përgjithshëm** | **14,757,751** | **20,738,345** | **24,384,545** | **20,158,545** | **18,346,467** | **98,385,653** | **100.00%** |




*Për të eleminuar efektin financiar (hendekun financiar), është krijuar një fond rezervë për vitet 2017-2020.*

| Shuma | në Euro |
|---|---|
| Kostot totale për zbatimin e Strategjisë | 98,385,653 |
| Hendeku financiar para fondit rezervë | 92,285,653 |
| Hendeku financiar pas Fondit Rezervë | 34,822,967, specifikisht 35% të kostove totale |



Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi masën e disbursimit financiar në bazë aktiviteti të kryer. *Nga analiza për aktivitetet e raportuara rezulton se për **vitin 2018** janë alokuar në total rreth* **1,038,457,491** *Lekë*[7]. *Përsa i përket buxhetit të raportuar për **vitin 2017**, rezultoi se ishin alokuar në total rreth 627,068,069 Lekë. Në vitin 2018 janë alokuar 411,389,422 lekë më shumë se një vit më parë.*

## IV. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së secilit objektiv të Strategjisë dhe pasqyron grafikisht statusin e zbatimit të Strategjisë për periudhën janar – dhjetor 2018[8].

### Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 1

| Janar – Dhjetor 2018 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 1** | **Numri i nën-aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 1** |
| Të realizuara | 8 | 19% |
| Në proces | 3 | 7% |
| Të parealizuara | 31 | 74% |
| **Totali** | **42** | **100%** |




[7] Buxheti i cili është i njëjtë për disa nga nën-aktivitetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për një pjesë të nën-aktiviteteve të Shkollës së Magjistraturës është përllogaritur vetëm një herë në koston totale të SND-së, pasi është i njëjti zë, i cili përsëritet në disa nën-aktivitete.

[8] Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është pasqyruar në aneksin 2 të Raportit të Monitorimit.




***Rezulton se nga 42 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 1 janë realizuar 8 prej tyre, 3 janë ende në proces zbatimi, 31 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 19% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 7% nën-aktivitetet në proces, 74% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

***Vlen të theksohet se MD në bashkëpunim me Kuvendin dhe me asistencën e EURALIUS, OPDAT, USAID kanë bërë një vlerësim paraprak për indentifikimin dhe koston financiare që do të shoqërojë ngritjen e të gjitha organeve të reja (KLGJ, KLP, KED, ILD dhe institucionet kundër Korrupsionit: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar/Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Njësia e Posaçme Hetimore/Byroja Kombëtare e Hetimit).***

## Objektivi 2: Konsolidimi i edukimit dhe trajnimit ligjor, si dhe specializimi i magjistratëve dhe personelit të gjykatave.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 2

| **Janar – Dhjetor 2018** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 2** | **Numri i nën-aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 2** |
| Të realizuara | 8 | 62% |
| Në proces | 1 | 8% |
| Të parealizuara | 4 | 30% |
| **Totali** | **13** | **100 %** |







***Rezulton se nga 13 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 2 janë realizuar 8 prej tyre, 1 është ende në proces zbatimi, 4 nën-aktivitete janë të parealizuara nga institucionet përgjegjëse.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 62% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 8% nën-aktivitetet në proces, 30% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

## Objektivi 3: Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasistetin, transparencën dhe aksesueshmërinë e tij në përputhje me standardet evropiane.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 3

| Janar – Dhjetor 2018 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 3** | **Numri i nën-aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 3** |
| Të realizuara | 10 | 77% |
| Në proces | 1 | 8% |
| Të parealizuara | 2 | 15% |
| **Totali** | **13** | **100 %** |







***Rezulton se nga 13 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 3 janë realizuar 10 prej tyre, 1 është ende në proces zbatimi dhe 2 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 77% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 8% nën-aktivitetet në proces dhe 15% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

## Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 4

| Janar – Dhjetor 2018 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 4** | **Numri i nën-aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 4** |
| Të realizuara | 17 | 74% |
| Në proces | 1 | 4% |
| Të parealizuara | 5 | 22% |
| **Totali** | **23** | **100 %** |







***Rezulton se nga 23 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 4 janë realizuar 17 prej tyre, 1 është ende në proces zbatimi dhe 5 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 74% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 4% nën-aktivitetet në proces dhe 22% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

**Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.**

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 5

| Janar – Dhjetor 2018 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 5** | **Numri i nën-aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 5** |
| Të realizuara | 3 | 10% |
| Në proces | 9 | 30% |
| Të parealizuara | 18 | 60% |
| **Totali** | **30** | **100 %** |







***Rezulton se nga 30 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 5 janë realizuar 3 prej tyre, 9 janë ende në proces zbatimi dhe 18 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 10% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 30% nën-aktivitetet në proces dhe 60% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

## Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 6

| Janar – Dhjetor 2018 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 6** | **Numri i nën-aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 6** |
| Të realizuara | 9 | 52% |
| Në proces | 4 | 24% |
| Të parealizuara | 4 | 24% |
| **Totali** | **17** | **100%** |







***Rezulton se nga 17 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 6 janë realizuar 9 prej tyre, 4 janë ende në proces zbatimi dhe 4 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 52% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 24% nën-aktivitetet në proces dhe 24% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

## Objektivi 7: Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë krejtësisht të reja apo thelbësisht të ndryshuara.

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 7

| Janar – Dhjetor 2018 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 7** | **Numri i nën-aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 7** |
| Të realizuara | 13 | 32% |
| Në proces | 3 | 7% |
| Të parealizuara | 25 | 61% |
| **Totali** | **41** | **100 %** |







***Rezulton se nga 41 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 7 janë realizuar 13 prej tyre, 3 janë ende në proces zbatimi dhe 25 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 32% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 7% nën-aktivitetet në proces dhe 61% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

**Objektivi 8: Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe krijimi i kuadrit ligjor për arbitrazhin.**

Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 8

| Janar – Dhjetor 2018 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve të Objektivit 8** | **Numri i nën-aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivit 8** |
| Të realizuara | 6 | 27% |
| Në proces | 9 | 41% |
| Të parealizuara | 7 | 32% |
| **Totali** | **22** | **100 %** |







***Rezulton se nga 22 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 8 janë realizuar 6 prej tyre, 9 janë ende në proces zbatimi dhe 7 nën-aktivitete të parealizuara nga institucionet përgjegjëse.*** Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 27% për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, 41% nën-aktivitetet në proces dhe 32% nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

## V. ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – DHJETOR 2018.

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën 1-vjeçare, në zbatim të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë janë si më poshtë vijon:

- Një hap vendimtar në zbatimin e reformës në drejtësi shënoi ngritja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat janë dy shtyllat për një sistem gjyqësor të pavarur dhe cilësor.

- Më datë 11 dhjetor 2018, u mbajt Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në fund të procesit të votimit u përzgjodhën 6 prokurorë, si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

- Këshilli i Lartë i Prokurorisë mbajti takimin e parë më datë 19 dhjetor 2018, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit.

- Më datë 12 dhjetor 2018, u organizua Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në fund të procesit të votimit u përzgjodhën 6 gjyqtarë, si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor mbajti takimin e parë më datë 20 dhjetor 2018, gjatë të cilit u zgjodh Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit.

- Në mbledhjen e datës 22 dhjetor 2018, KLGJ, duke pasur parasysh rëndësinë e zgjedhjes së nënkryetarëve të gjykatave dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në kushtet kur gjykata mbetet pa kryetar, hapi rrugën duke miratuar rregullat për zgjedhjen e nënkryetarëve të gjykatave.

- Lidhur me përmirësimin e infrastrukurës ndërtimore në gjykata, gjatë kësaj periudhe ka përfunduar rikonstruksioni i plotë i godinës së Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, e cila garanton ambjentet e punës për stafin, si dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore, shërbim cilësor e transparent për publikun në ambjent të posacëm për këtë qëllim, etj. Gjykata aktualisht po zhvillon aktivitetin e saj në godinën e rikonstruktuar.

- Në datën 17.05.2018, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 26/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 385, datë 24.2.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".

- Asambleja e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetesve ka miratuar "Programin e Kurrikulave të Trajnimit Fillestarë", "Programin e Kurrikulave të Trajnimit të Vazhduar", "Rregullore Trajnimit Fillestar", "Rregullore Trajnimit të Vazhduar", "Udhëzim i përbashkët i tarifave të shërbimit të Ndërmjetësimit".

- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka realizuar përgatitjen dhe shpërndarjen e broshurave, fletëpalosjet dhe bluzat për fushatë informuese.

- Takime të vazhdueshme janë zhvilluar me aktorë të ndryshëm në Gjykata, Prokurori, Komunitet për të ndërgjegjësuar për të përdorur zgjidhjet alternative në mosmarrëveshje.

- Ka përfunduar përmirësimi i sistemit të arkivës së gjyqësorit nëpërmjet zbatimit dhe funksionimit të arkivës qendrore të gjykatave pasi në zbatim të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", AKSHI ka mundësuar ofrimin e shërbimit të internetit për Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, si dhe bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues ERT Nr. 437 datë 21.02.2008, AKEP ka mundësuar rregjistrimin e emrit të domain-it: ashsgj.gov.al.

- Në muajin tetor 2018, Prokuroria e Përgjithshme miratoi "Rregulloren e Prokurorisë së Përgjithshme", Udhëzimin e përgjithshëm "Mbi Përgjimet"; si dhe Udhëzimin "Për koordinimin në çështjet e ekstradimit për jashtë shtetit".

- Shkolla e Magjistraturës ka realizuar hartimin e kurrikulave, si dhe ka kryer trajnimet përkatëse që lidhen me përmbushjen e këtij objektivi.

  - Gjithashtu, në kuadër të ndryshimit të legjislacionit penal në përputhje me standardet evropiane, Shkolla e Magjistraturës ka vijuar me trajnimet për prokurorë e gjyqtarë. Disa prej temave të trajtuara në këto trajnime janë: "Rishikimi i vendimit të formës së prerë në Procesin Penal. Risitë e Kodit Procedural Penal", "Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake", "I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe risitë që sjellin ndryshimet e KPP-së.", "Padia civile në procesin penal", "Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin", "Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;" etj.

- Në 15 maj 2018 u zhvillua një trajnim një ditor me stafin antikorrupsion pranë Ministrisë së Drejtësisë, me tematike: "Kontrolli i brendshëm, vlerësimi i riskut dhe planet e integritetit".

- Gjatë vitit 2018 është bërë i mundur implementimi i modulit të përgjimeve, është përfunduar moduli i Prokurorisë së Përgjithshme dhe moduli i Apeleve dhe janë në fazë testimi.

- Në muajin qershor 2018, në kuadër të rishikimit të paktës kombëtare të projekteve strategjike Prokuroria e Përgjithshme ka identifikuar nevojën për mbështetje për decentralizimin e përgjimeve.

- Shkolla e Magjistraturës ka zhvilluar disa aktivitete për prokurorët me tema si: Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal; teknikat e posacme të hetimit; hetimet proaktive. Në muajin korrik në DPPSH është organizuar një aktivitet për përgjimin taktik (IMCI CATCHER), ku kanë qenë oficerë të policisë gjyqësore të drejtorisë së përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të prokurorisë Tiranë.

- Referuar punësimit për të paraburgosurit dhe të dënuarit për periudhën 1-vjeçare ka pasur një numër prej mesatarisht **649 personash** të punësuar në muaj nga të cilët 144 të paraburgosur dhe 505 të dënuar.

- Shtetasit e burgosur në prag lirimi trajtohen me programe specifike për këtë kategori me qëllim reduktimin e recidivizmit. Stafi social në IEVP-të kryen trajnimin e kësaj kategorie në drejtim të përvetësimit të disa shprehive sociale, aftësive bazë për tu përballur me tregun e punës, forcimin e lidhjeve me të afërmit dhe komunitetin, si dhe referimin e rasteve pa përkrahje sociale pranë institucioneve përkatëse shtetërore. Për periudhën janar - dhjetor 2018 këto programe janë ofruar për rreth 210 shtetas të burgosur në muaj.

- Për periudhën Janar-Dhjetor 2018 stafi social në IEVP-të ka trajtuar me programin "për ish përdoruesit e lëndëve narkotike" rreth **315 të burgosur** ish përdorues të lëndëve narkotike, nga të cilët rreth 66 persona trajtohen paralelisht me terapi medikamentoze nga stafi mjekësor në bashkëpunim me Aksion Plus. Ky program synon stabilizimin e gjendjes psiko-emocionale në kushtet e privimit nga liria dhe ka si objektiv afatgjatë, rehabilitimin e tyre.

- Numri i aktiviteteve rehabilituese të organizuara *mesatarisht në muaj* gjatë periudhës janar - dhjetor 2018 me të dënuarit/të paraburgosurit në IEVP është 457. Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën aktivitetet kulturore e sportive *në muaj* në institucion është 3740. Në IEVP janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 210 tema sociale *në muaj*, ku kanë marrë pjesë mesatarisht 2900 të burgosur *në muaj*.

- Sektori i Trajnimeve në DPB ka zhvilluar trajnime bazë për stafin e rekrutuar rishtas. Për periudhën janar-dhjetor 2018 janë përfshirë në këto trajnime **1.689 punonjës.** Për realizimin e trajnimeve sa më profesionale dhe të frytshme për grupin e synuar është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Sigurisë, e cila ka ofruar ambientetet dhe burime njerëzore për realizimin dhe mbarëvajtjen e trajnimeve.

- Nëpërmjet procedurave të hapura të konkurimit janë përzgjedhur 24 drejtuesit e burgjeve në vend, si dhe është kryer përzgjedhja e stafit të niveleve të ndryshme, duke synuar forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit të burgjeve, rritjen e integritetit dhe përmirësimin e imazhit dhe shërbimeve për gjithë qytetaret. Drejtuesit e përzgjedhur janë trajnuar nga Sektori i Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

- Është realizuar furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të vëzhgimit (mbikqyrjes) në IEVP "Jordan Misja", Tiranë.

- Përsa i përket rritjes së kapaciteteve institucionale dhe profesionale të Komitetit Shqiptar të Birësimit është realizuar trajnimi për 3 punonjës të këtij institucioni.

- Në shkurt 2018, është ngritur "Rrjeti i RIA-s", me përfaqësues nga ministritë e linjës (3 përfaqësues nga çdo ministri), si dhe Njësia e Programimit dhe Akteve Rregullatore (Njësia e RIA-s) në Kryeministri. Rrjeti i RIA-s ka në fokus koordinimin, administrimin e procesit të vlerësimit të ndikimit gjatë fazës së hartimit të projektakteve ligjore, në bashkëpunim me njësitë hartuese të legjislacionit/politikave.

    - Në muajin Mars 2018, u finalizua metodologjia e vlerësimit të ndikimit (RIA), me mbështetjen e SIGMA, si dhe u organizuan trajnimet e para për zbatimin e metodologjisë. Në qershor 2018, u organizuan trajnime të tjera me rrjetin e RIA-s, me

mbështetjen e SIGMA-s, në të cilin u trajtuan raportet e vlerësimit të ndikimit që secila ministri kishte plotësuar në fazën e parë, sipas udhëzimeve të metodologjisë së RIA-s.

- Për vitin 2018 u përcaktuan **13 projektligje** për t'iu nënshtruar procesit të vlerësimit të ndikimit. Deri në fund të vitit 2018, vlerësimet e ndikimeve kanë kaluar fazën e parë të përgatitjes nga ministritë e linjës dhe shqyrtimit nga Kryeministria. Në vijim, vlerësimet e ndikimit, në fazën finale të tyre, priten të përcillen në Kryeministri nëpërmjet sistemit e-akte.

- Është hartuar plani i punës për konsultimin publik. Është konsoliduar dhe përditësuar manuali për përdorimin e rregjistrit elektronik të konsultimit publik me qëllim konsultimin e akteve nga rrjeti/koordinatorët e konsultimit publik. Pas finalizimit të rrjetit të konsultimit publik, janë organizuan dy seanca trajnimi dhe një workshop për të gjithë koordinatorët, ku u trajnuan rreth 70 persona lidhur me procesin e konsultimit dhe funksionimin e rregjistrit elektronik për konsultimin publik.

- Përsa i përket përmirësimit të sistemit të njoftimeve publike dhe konsultimit të legjislacionit, Ministria e Drejtësisë ka publikuar në faqen www.konsultimipublik.gov.al, të gjitha aktet objekt të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky proces do të ndiqet në vijimësi sa herë që ka projektakte që duhet të konsultohen.

## VI. ANALIZË KRAHASIMORE LIDHUR ME ECURINË E PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITIN 2017 DHE VITIN 2018

**Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve për vitet 2017 dhe 2018**



Përsa i përket statusit të nën-aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë rezultoi se për vitin 2017 janë realizuar **59** prej tyre, **35** janë ende në proces zbatimi dhe **107** nën-aktivitete të parealizuara (nga të cilat 65 nën-aktivitete janë nën fushën e përgjegjësisë së institucioneve e reja të sistemit të drejtësisë, të cilat gjatë vitit 2017 nuk ishin krijuar ende).

Në vijim, gjatë vitit 2018, nga 201 nën-aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë realizuar **74** prej tyre, **31** janë ende në proces zbatimi dhe **96** nën-aktivitete të parealizuara (nga të cilat 65 nën-aktivitete janë nën fushën e përgjegjësisë së institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë).

**Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për vitet 2017 dhe 2018**




Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit **për vitin 2017** është në nivelin **29%** për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, **18%** nën-aktivitetet në proces dhe **53%** nën-aktivitetet e parealizuara.

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit **për vitin 2018** është në nivelin **37%** për nën-aktivitetet të cilat janë të realizuara, **15%** për nën-aktivitetet në proces, **48%** për nën-aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

*Përsa më sipër, rezulton se **për vitin 2018** janë realizuar **15** nën-aktivitete më shumë se viti 2017, ndërsa nën-aktivitetet në proces janë ulur me **4** krahasuar me një vit më parë. Numri i nën-aktiviteteve të parealizuara janë **11** më pak se viti 2017.*

## VII. NEVOJA PËR RISHIKIM TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË

Institucionet kanë raportuar nevojën për rishikimin e Planit të Veprimit të SND-së, në mënyrë që aktivitetet e saj të konvertohen në përfitime konkrete, për targetin të cilit i drejtohen, si dhe të fokusohen në çështjet më të domosdoshme për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.

Kjo nevojë për rishikim lidhet kryesisht me faktorë si:

- moskrijimi në kohë i institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë si Inspektori i Lartë i Drejtësisë, SPAK, si dhe Byroja Kombëtare e Hetimit.
- rishikimin e aktiviteteve dhe/apo treguesve të saj të zbatimit në mënyrë që të sigurohet një përputhshmëri më e mirë me realizimin e qëllimit;
- ndryshimin e përgjegjësisë institucionale për zbatim dhe/apo institucioneve bashkëpunuese, pasi jo në pak raste vihet re që ka problematikë në përcaktimin e institucionit përgjegjës për realizimin e një aktiviteti;
- ndryshimin dhe/apo buxhetimin aty ku mungon, të kostos financiare për çdo aktivitet;
- realizimin e gjithërfshirjes së aktorëve të sistemit të drejtësisë në planifikimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit në përputhje me objektivat strategjikë, por dhe në kuadër të fushës së përgjegjësisë të çdo institucioni.

## VIII. KONKLUZIONE

Realizimi i reformës në drejtësi është një proces i vazhdueshëm ndërsektorial, ku vetë përcaktimi dhe matja e treguesve përfundimtar të suksesit është kompleks, sidomos në një kuadër ligjor dhe institucional në reformim të vazhdueshëm.

Zbatimi i suksesshëm i reformave në sektorin e drejtësisë për të siguruar një sistem gjyqësor efektiv, efikas, të pavarur dhe transparent, në përputhje me praktikat më të mira evropiane mbetet misioni i kësaj strategjie.

Gjatë kryerjes së procesit të monitorimit janë evidentuar disa problematika që vlerësohen se kanë ndikuar në nivelin e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit. Ndër elementët më të rëndësishëm të cilët kanë ndikuar në realizimin e ulët të aktiviteteve të parashikuar në këtë Plan Veprimi janë si më poshtë:

- Moskrijimi në kohë i institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë si: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, SPAK dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Për më tepër, krijimi me vonesë i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë muajit dhjetor 2018 dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në muajin janar 2019, ka ndikuar në realizimin e ulët të aktiviteteve të Planit të Veprimit, i cili do të implementohet në vijim nga këto institucione. Për këtë arsye, duke qenë se një pjesë e madhe e aktiviteteve (65 nën-aktivitete në total) në këtë Plan Veprimi, kishin si institucione përgjegjëse për zbatimin e tyre pikërisht organet e reja të sistemit të drejtësisë, moskrijimi i tyre në kohë ka ndikuar në performancën e ulët të

realizimit të Planit të Veprimit për këtë periudhë dhe njëkohësisht dhe në zbatimin e ulët të objektivave të përcaktuara në këtë strategji.

Gjatë kësaj periudhe, zbatimi dhe monitorimi, si dy procese të ndërlidhura që kanë orientuar Ministrinë e Drejtësisë drejt reflektimit dhe konkluzioneve, mund të përmendim ndër më kryesoret:

- Nevojën për miratimin e draft-Planit të Veprimit sa më parë.
- Nevojën për miratimin e draft-Pasaportës së Treguesve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.
- Hendeku financiar i Strategjisë mbetet ende problematik dhe prek direkt zbatueshmerinë e planit. Nevojitet prioritizimi i masave dhe mobilizimi i mekanizmave institucionalë për adresimin e hendekut financiar dhe gjetjes së burimeve financiare. Gjithashtu, ndërlidhja me PBA-në dhe parashikimi i mbulimit financiar nga Buxheti i Shtetit duhet të përmirësohet. Plani i ri i Veprimit duhet të adresojë këto mangësi, duke adresuar kështu dhe raportimin financiar.
- Problematikë mbetet përgjegjshmëria e institucioneve për raportimin në kohë dhe me cilësi të informacionit mbi aktivitetet e Planit të Veprimit, si dhe informacionin mbi disbursimin financiar. Nevojitet një bashkëpunim më i lartë i Dhomave, në veçanti të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë, për të kontribuar dhe raportuar lidhur me implementimin e Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

## IX. SFIDAT

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- Sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi gjatë fazave të raportimit, monitorimit dhe rishikimit të Planit të Veprimit me institucionet përgjegjëse dhe grupet e interesit.
- Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.
- Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Ndërlidhja me procesin e planifikimit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që të sigurohet mbulimi i nevojshëm financiar nga Buxheti i Shtetit për ato masa që parashikohen të zbatohen nëpërmjet Buxhetit të Shtetit.
- Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.

## ANEKS 1

Ligjet e miratuara nga paketa prej 27 ligjesh janë si më poshtë vijon:

1. Ligji nr. 35/2017 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar*;
2. Ligji nr. 36/2017 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, date 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar"*;
3. Ligji nr. 37/2017 *"Kodi i Drejtësisë për të Mitur"*;
4. Ligji nr. 32/2017 "Për disa ndryshime dhe *shtesa në ligjin nr. 10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", i ndryshuar*;
5. Ligji nr. 69/2017 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 04.12.2003 "Për përgjimin e komunikimeve elektronike", i ndryshuar";*
6. Ligji nr. 70/2017 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"*;
7. Ligji nr.43/2017 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013 "Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit"*;
8. Ligji nr. 44/2017 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar;*
9. Ligji nr. 42/2017 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar*;
10. Ligji nr. 38/2017 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar*;
11. Ligji nr. 40/2017 *"Për disa ndryshime në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar*;
12. Ligji nr. 39/2017 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar";*
13. Ligji nr. 41/2017 *"Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar";*
14. Ligji nr. 111/2017 *"Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti";*
15. Ligji nr. 98/2017 *"Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë";*
16. Ligji nr.26/2018 *"Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve";*
17. Ligji 55/ 2018 *"Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë";*

18. Ligji Nr.80/2018 *"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar;*
19. Ligji Nr.86/2018 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit".*

## ANEKS 2

# Plani i Veprimit i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017 - 2020

(Për periudhën janar - dhjetor 2018)

### Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmerisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.

| Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Institucioni përgjegjës | Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro) | Buxheti i alokuar për çdo aktivitet | Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2018 (E realizuar/në proces/parealizuar) | Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Objektivi 1: Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë*** | | | | | | |
| **Aktivitet 1.01** | **Forcimi i statusit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, përfshirë ndihmës-magjistratët/ këshilltarët ligjorë në përputhje me standardet evropiane që sigurojnë emërim dhe zhvillim të karrierës që janë të bazuara në meritë, janë objektive dhe transparente (duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese). Ngritja e një sistemi të zhvillimit të karrierës për të gjithë profesionistët që janë pjesë e sistemit gjyqësor.** | | | | | |
| 1.01.b | Vënia në zbatim e ndryshimeve të niveleve të pagave dhe pagesave etj -Gjyqtarët e të gjitha gjykatave<br>- Vënia në zbatim e ndryshimeve të niveleve të pagave dhe pagesave etj - prokurorët<br>- Vënia në zbatim e ndryshimeve të niveleve të pagave dhe pagesave etj - ndihmës magjistratët. | *(KLGJ, KLP) KLD, ZABGJ* | 570,117<br>393,276<br>470,721 | 671.931.842 lekë për 357 gjyqtarë;<br><br>49.791.329 lekë për 31 ndihmës magjistratë | Në proces | **KLGJ:** Ndryshimet e niveleve të pagave janë parashikuar të fillojnë në muajin Janar 2019 dhe do të jetë përgjegjësi e KLGJ.<br><br>Për vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të alokuar për këtë qëllim.<br><br>**ZABGJ:** Nuk ka ndryshime në pagat e gjyqtarëve për vitin 2018; referuar ligjit pagat e reja hyjnë në fuqi në 1 janar 2019.<br>Për 12 Mujorin, buxheti i realizuar (fakt) në shpenzime personeli për 357 gjyqtarë (nr.fakt) është 671,931,842 lekë;. Kursi i kembimit sipas BSH datë 31/12/2018 është 1 euro = 123,42 lekë. Pra 5,444,270 euro.<br><br>Për të njëjtën periudhë, buxheti i realizuar (fakt) në shpenzime personeli për 31 ndihmës magjistratë (nr.fakt) është 49,791,329 lekë;. Kursi i këmbimit sipas BSH datë 31/12/2018 është 1 euro = 123,42 lekë. Pra 403,430 euro. |
| 1.01.c | Analiza e nevojave për trajnim. | *SHM, KLGJ, KLP* | | 153.999 lekë | E realizuar | **SHM:** Analiza e nevojave për trajnim është një proces i cili realizohet përgjatë vitit, fillimisht nga sektori i Formimit Profesional, konkretisht, dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, përgjegjësi i sektorit të Formimit Profesional dhe Pedagogu përgjegjës për Programin e Formimit Vazhdues. Për të realizuar këtë analizë të nevojave për trajnim është punuar gjithashtu nga këshilltari akademik dhe Drejtori i Shkollës. Në përmbyllje të procesit është Këshilli Drejtues ai që bën vlerësimin e nevojave dhe vendos lidhur me aktivitetet përkatëse që do të zhvillohen nga shkolla. Kjo analizë nevojash është konsideruar e përmbushur sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë në proces, sipas përqindjeve të caktuara. Pra edhe kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit pagë. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, për 2 muaj në vit, (28500 lekë);<br>b) 5% e pagës për përgjegjësin e sektorit të Formimit Profesional, për 1 muaj, (4455 lekë);<br>c) 10% e pagës për këshilltarin akademik, për 1 muaj, (9975 lekë);<br>d) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës për Formimin Vazhdues, për 4 muaj (52749 lekë);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë); |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | f) 20% e kostos së 2 mbledhje të Këshillit Drejtues të Shkollës (43800 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 153.999 lekë. |
| 1.01.d | Krijimi i kurrikulave/ trajnimeve pilote. | *SHM* | | 179.287 lekë | E realizuar | Hartimi i kurrikulave është një proces i cili është realizuar nga stafi i brendshëm i shkollës, sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë, sipas përqindjeve të caktuara dhe nga staf i jashtëm në pozicionin e ekspertit në trajnimin vazhdues. Pra kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit page dhe pjesë e pagesës së dhënë ekspertëve për trajnimet. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për keshilltarin akademik, për 2 muaj, (19942.5 lekë);<br>b) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës, 7 pedagog të brendshëm në Formimin Fillestar, për 1 muaj (61542 lekë);<br>c) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës në Formimin Fillestar, për 2 muaj (17583.4 lekë);<br>d) 4 orë për cdo aktivitet trajnues për ekspertët në përmbushje të detyrimit të tyre për përgatitje për aktivitetin trajnues (llogaritjen në lekë e përfshijmë në koston totale të aktivitetit trajnues);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>f) 30% e 2 mbledhje të Këshillit Drejtues të Shkollës (65700 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 179.287 lekë. |
| 1.01.e | Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve. | *SHM* | | 7.309.500 lekë | E realizuar | Trajnimet që lidhen me këtë objektiv që janë realizuar në periudhën janar-dhjetor 2018, janë:<br>1. 15-16 janar 2018 “Caktimi i dënimit penal nga gjykata. • Kriteret e caktimit të dënimit me fokus në nenin 47 dhe vijues të Kodit Penal. Trajtesa teorike dhe praktika gjyqësore lidhur me caktimin e dënimit penal nga gjykata; • Caktimi i dënimit për veprën penale të mbetur në tentativë, për personat e dehur dhe ata me probleme të shëndetit mendor; Personat me probleme të shëndetit mendor: mirëqenia mendore: kuptimi; promovimi i mirëqenies mendore; stresi dhe menaxhimi i tij; • Caktimi i dënimit në rastin e njohjes së një vendimi të një gjykate të huaj.”;<br>2. 22-23 janar 2018 “Roli i alternativave të dënimit me burgim dhe shërbimi i provës. • Risitë e Kodit Penal lidhur me alternativat e dënimit me burgim. Ligji "Për shërbimin e provës" dhe dispozitat procedurale penale; •Lirimi me kusht si një nga alternativat e dënimit me burgim; • Praktika gjyqësore; • Marrëdhëniet e shërbimit të provës dhe prokurorisë.”;<br>3. 5-6 shkurt 2018 “E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase.”;<br>4. 12 shkurt 2018 “Procesi i të provuarit gjatë gjykimit civil.”;<br>5. 7-8 shkurt 2018 “Risitë e legjislacionit shqiptar me ndikim mbi statusin, organizimin dhe veprimtarinë e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit. • Ligji për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë nr. 115/2016; • Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë nr. 96/2018; • Ligji për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë nr. 98/2016.”;<br>6. 9 mars 2018 “Zbatueshmëria e parimit kushtetues së të drejtës për të mos u gjykuar dy herë (ne bis in idem) në këndvështrimin kushtetues, KEDNJ-së (neni 4 i Protokollit nr.7).”;<br>7. 15-16 mars 2018 “Lidership i ekipit drejtues.”;<br>8. 11-13 prill 2018 “Shkenca dhe ligji.”;<br>9. 27 prill 2018 “Procesi i të provuarit gjatë gjykimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | civil.";<br>10. 11-12 prill 2018 "Risitë e legjislacionit shqiptar me ndikim mbi statusin, organizimin dhe veprimtarinë e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit. • Ligji për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë nr. 115/2016; • Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë nr. 96/2018; • Ligji për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë nr. 98/2016.";<br>11. 16-17 prill 2018 "Zbatimi i ligjit të BE-së nga gjykatat kombëtare";<br>12. 30 prill 2018 Risitë e ligjit "Për tregtarët e shoqëritë tregtare";<br>13. 14-15 maj 2018 "Dialogu gjyqesor dhe roli i vendimeve te Gjykatave Europiane ne planin e brendshem ( GJEDNJ dhe GJDBE)";<br>14. 16-17 maj 2018 "Përqasja e legjislacionit shqiptar me të drejtën komunitare në fushën e prokurimeve publike.";<br>15. 18 maj 2018 "Roli i Avokatit të Shtetit në procesin gjyqësor.";<br>16. 21-22 maj 2018 "Kriteret për vlerësimin e efektivitetit të mjeteve ankimore në reflektim të jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe vendimmarrjeve në çështjet kundër Shqipërisë."<br>17. 24-25 maj 2018 "E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase.";<br>18. 1 qershor 2018 "Përqasja e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e sigurimeve nga kompanitë e sigurimeve.";<br>19. 31 maj – 1 qershor 2018 "E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase.";<br>20. 7-8 qershor 2018 "E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase.";<br>21. 8 qershor 2018 "Mbi rolin e kryetarëve të gjykatave.";<br>22. 12-13 qershor 2018 "E drejta e pronës në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe problematika e legjislacionit dhe praktikës vendase.";<br>23. 20-21 qershor 2018 "Arsyetimi dhe gjykimi. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore si standard kushtetues".<br>24. 25-26 qershor 2018 "Zbatimi i se drejtes europiane nga gjykatat kombetare";<br>25. 27 qershor 2018 "Gjykata, prokuroria dhe media, tre aktorë mbështetës të sistemit të drejtësisë, të drejtave të palëve në proces dhe interesit publik për të marrë informacion";<br>26. 28-29 qershor 2018 "Inteligjenca emocionale dhe procesi i vendimmarrjes.";<br>27. 28 qershor 2018 "Raporti i gjykatës dhe prokurorisë me median. Roli i magjistratit të shtypit në balancimin e interesit të palëve në proces dhe interesit publik për të marrë informacion.";<br>28. 29 qershor 2018 "Raporti i gjykatës dhe prokurorisë me median. Roli i magjistratit të shtypit në balancimin e interesit të palëve në proces dhe interesit publik për të marrë informacion".<br>29. 9 Korrik 2018 "Standardet e GJEDNJ ne lidhje me azilin dhe migracionin e paligjshem"; 30. 10 Korrik "Standardet e GJEDNJ ne lidhje me azilin dhe migracionin e paligjshem";<br>31. 11-12 Korrik "Risitë lidhur me aksesin në gjykimin kushtetues. Qasja e gjykatave dhe e subjekteve pjesëmarrëse (roli i gjykatës gjatë procesit, kur palët |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | ngrenë probleme antikushtetutshmërie; vonesat gjatë gjykimit etj.). Kontrolli incidental kushtetues."<br>32. 5 tetor 2018 "Sfida të zbatimit të standardeve europiane në lirinë e shprehjes në kontekstin shqiptar",<br>33. 8 tetor 2018 "Liria e shprehjes dhe medias – Standarde të parashikuara në KEDNJ dhe jurisprudencë e GJEDNJ-së dhe aplikimi i tyre në kontekstin shqiptar;"<br>34. 9 tetor 2018 "Liria e shprehjes dhe medias – Standarde të parashikuara në KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe aplikimi i tyre në kontekstin shqiptar;"<br>35. 15-16 tetor 2018 "Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin."<br>36. 22 tetor 2018 "Respektimi i të drejtës së autorit për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, por dhe institucionet e tjera zbatuese."<br>37. 23-26 tetor 2018 "Metodat e avancuara te trajnimit (Grupi i Punës për Hartimin e Programit të Administrimit të Gjykatës).<br>38. 25-26 tetor 2018 "Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit."<br>39. 26 tetor 2018 "Investigimi i rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve (ëorkshop tematik për prokurorë përfshirë përfaqësues të ligjit).<br>40. 29-30 tetor 2018 "Protokolli XVI i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, dilemat europiane dhe shqiptare. Kërkesat për interpretim të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese drejtuar GJEDNJ-së sipas protokollit XVI të KEDNJ-së. Përqasja e protokollit XVI të KEDNJ-së me kërkesat paragjykimore përpara Gjykatës Europiane të Drejtësisë sipas të drejtës së Bashkimit Europian. Modele gjykimi incidental sipas legjislacioneve të vendeve të ndryshme."<br>41. 29-30 tetor 2018 "Legjislacioni "Për tregtarët e shoqëritë tregtare". Riorganizimi i shoqërive tregtare (bashkimi, ndarja, likuidimi). Kriteret ligjore dhe ato ekonomike që duhen zbatuar nga shoqëritë tregtare: problemet e evidentuara nga praktika gjyqësore;"<br>42. 29-30 tetor 2018 "Kontrolli kushtetues incidental; Evoluimi i kontrollit incidental kushtetues; Refleksione procedurale; Parimi i supremacisë, parimi i efektit të drejtpërdrejtë, dhe parimi i kushtetueshmërisë funksionale sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese;"<br>43. 31 tetor 2018 "Përcaktimi i juridiksionit ndërkombëtar sipas Ligjit për të Drejtën Ndërkombëtare private dhe Kodit të Procedurës Civile me risitë e tij."<br>44. 31 tetor 2018 "Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave;"<br>45. 1-2 nëntor 2018 "Efiçenca gjyqësore dhe menaxhimi aktiv i çështjeve me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile. Sfidat me të cilat përballen gjyqtarët, prokurorët, mbrojtësit ligjor dhe pjesëmarrësit e tjerë në gjykim përsa i përket efiçencës së proceseve gjyqësore;"<br>46. 1-2 nëntor 2018 "Mbi disa amandime të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" (Ligji antimafia)"<br>47. 1-2 nëntor 2018 "Jurisprudenca e GJEDNJ-së kundër Shqipërisë"<br>48. 5-6 nëntor 2018 "Procedimet në dhomë këshillimi: Procedimet mbi kërkesën e palëve dhe ex officio. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Njoftimi i procedimit në dhomë këshillimi i palëve që kanë interes. Revokimi dhe ndryshimi i vendimeve të marra në dhomë këshillimi. Palët e legjitimuara për të kërkuar ndryshimin ose revokimin e vendimeve të marra në dhomë këshillimi. Të drejtat e fituara nga të tretë për shkak të vendimeve të marra në dhomë këshillimi. Procedura e shqyrtimit të padive për shuma të vogla. Risitë e këtij gjykimi."<br>49. 5-6 nëntor 2018 "Ankimi kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës, në rastin e kundërvajtjeve penale. Roli i gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe i seancës paraprake dhe problemet e praktikës gjyqësore."<br>50. 7-8 nëntor 2018 "Zhvillimi i një procesi gjyqësor dhe procesit të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm. • Kohëzgjatja e paarsyeshme e procedurave të gjykimit dhe të procesit administrativ, si dhe e ekzekutimit të vendimeve; • Pritshmëritë nga ndryshimet në ligjet materiale dhe procedurale. (procedurat civile dhe penale, ligji për Gjykatën Kushtetuese etj.; Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me afatin e arsyeshëm); • Kërkimi dhe zbatimi i mjeteve efektive për parandalimin e shkeljeve që lidhen me gjykimin në afat; • Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me afatin e arsyeshëm. • Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv; Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit. Shqyrtimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe masa e dëmshpërblimit sipas kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut."<br>51. 7-8 nëntor 2018 "Ndërthurja e juridiksionit administrativ me atë civil në rastet e përmbushjes/mospërmbushjes së detyrimeve në një kontratë administrative (sipërmarrje, shitje, koncesioni, qiraje etj.) • Dallimi i bazës ligjore në gjykimin e çështjeve: i zbatimit të legjislacionit administrativ gjatë fazës dhe procedurave për lidhjen e kontratës nga zbatimi i Kodit Civil gjatë fazës së ekzekutimit të kontratës."<br>52. 7-8 nëntor 2018 "Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit."<br>53. 9 nëntor 2018 "Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave;"<br>54. 9 nëntor 2018 "E drejta e marrjes së informacionit – si po zbatohet ligji në praktikë? (ëorkshop tematik për gjyqtarë përfshirë përfaqësues të agjencisë rregullatore të mediave dhe gazetarë me eksperiencë).<br>55. 12-13 nëntor 2018 "Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve;"<br>56. 12-13 nëntor 2018 "Provat dhe papërdorshmëria e provave të marra në kundërshtim me ligjin. Raporti i aktit të pavlefshëm me përdorshmërinë e provës së marrë nëpërmjet tij. Këndvështrim krahasues me doktrinën dhe jurisprudencën e huaj."<br>57. 13-14 nëntor 2018 "Etika e komunikimit dhe llojet e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | tij; Komunikimi me shkrim; Ndërtimi i tekstit për të lidhur rrjedhshmërinë me përmbajtjen. Komunikimi verbal dhe ai joverbal në gjykatë; Përmirësimi i komunikimit të bashkëbisedimit gjatë gjykimit. Roli i gjyqtarit dhe sjellja e aktorëve të tjetër procedural: prokurori, mbrojtësi, i pandehuri, viktima. Rëndësia e një komunikimi korrekt, sjellja etike, efektet e bashkëbisedimit në dhënien e një drejtësie sa më objektive dhe rritja e performances së organeve të drejtësisë. Komunikimi me popullata të veçanta. Ndërtimi i besimit nëpërmjet gjuhës së folur, efektet kulturore, efektet sociale dhe ekonomike. Shprehitë e komunikimit efektiv: Të dëgjuarit; komunikimi joverbal; komunikimi verbal; empatia etj.<br>58. 13-16 nentor 2018 "Planifikimi Strategjik (grupi i punës për hartimin e programit të administrimit të gjykatës)."<br>59. 14-15 nëntor 2018 "Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal;"<br>60. 14-15 nëntor 2018 "Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv për çështjet administrative;"<br>61. 15-16 nëntor 2018 "Efiçenca gjyqësore dhe menaxhimi aktiv i çështjeve me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile. Sfidat me të cilat përballen gjyqtarët, prokurorët, mbrojtësit ligjor dhe pjesëmarrësit e tjerë në gjykim përsa i përket efiçencës së proceseve gjyqësore;"<br>62. 15-16 nëntor 2018 "Parashkrimi shues dhe dekadenca. Kuptimi; Arsyet dhe rëndësia e institutit të parashkrimit; Kushtet e ekzistencës së faktit juridik të parashkrimit të padisë; Kufijtë e zbatimit të parashkrimit; Afatet e parashkrimit; Pezullimi i parashkrimit; Ndërprerja e përshkrimit; Pasojat juridike të parashkrimit të padisë; Dallimi i parashkrimit nga prekluziviteti ose dekadenca; Parashkrimi në të drejtën procedurale; Dallimi i regjimit juridik të parashkrimit të padisë në procesin administrativ dhe procesin civil; Ndryshimet e KPC në vitin 2017 mbi prapësimet në kuptimin e ngushtë dhe praktika gjyqësore."<br>63. 16 nëntor 2018 "Kufijtë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe roli i Gjykatës së Lartë në praktikën gjyqësore;"<br>64. 16 Nëntor 2018 "Liria e shprehjes dhe interneti"<br>65. 19 nëntor 2018 "Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".<br>66. 19-20 nëntor 2018 "Arsyetimi dhe gjykimi. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore si standard kushtetues - Efekti i jurisprudencës së GJK-së te gjykatat. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore dhe standardi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me këtë aspekt."<br>67. 20 nëntor 2018 "Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".<br>68. 20-21 nëntor 2018 "Përfundimi i marrëdhënieve të punës. • Kodi i Punës dhe problemet e evidentuara nga praktika gjyqësore. • Legjislacioni në marrëdhënien juridike të punësimit për punëmarrësit e punëdhënësit, në mënyrën e shkaqet e zgjidhjes së kontratave të punës me ose pa afat të caktuar. Të drejtat që gëzojnë mbrojtje ligjore në rrugë gjyqësore. Legjislacioni për parandalimin e diskriminimit në marrëdhëniet e punës: problemet e evidentuara nga praktika gjyqësore.<br>69. 21 nëntor 2018 "Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".<br>70. 21 nëntor 2018 "Neni 10 i KEDNJ-së dhe |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | evolucioni i përgjegjësisë civile sipas GJEDNJ-së dhe ndryshimeve në Kodin Civil.”<br>71. 21-22 nëntor 2018 “Integriteti i zyrtarëve të agjencive ligjzbatuese dhe lufta kundër korrupsionit. Korrupsioni i funksionarëve të lartë të drejtësisë dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë. • Korrupsioni si një çështje etike v si një vepër penale. • Kuadri ligjor dhe standardet ndërkombëtare; • Problemet e praktikës gjyqësore, në lidhje me hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave penale; • Standardet e kërkuara në marrëdhëniet profesionale midis gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe gjyqtarëve/prokurorëve dhe avokatëve.<br>72. 23 nëntor 2018 “Tatimi i vlerës së shtuar - diskutim i rasteve praktike; tatimi mbi të ardhurat - raste praktike.”<br>73. 26-27 nëntor 2018 “Kujdestaria alternative me bazë familjen. • Legjislacioni në fuqi lidhur me institutin e kujdestarisë dhe problematika e praktikës gjyqësore; • Përvoja ndërkombëtare pozitive dhe praktika e GJEDNJ-së lidhur me institutin e kujdestarisë; • Problemet e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi dhe nevoja e përqasjes me standardet ndërkombëtare.”<br>74. 26-27 nëntor 2018 “Zhvillimi i një procesi gjyqësor dhe procesit të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm. • Kohëzgjatja e paarsyeshme e procedurave të gjykimit dhe të procesit administrativ, si dhe e ekzekutimit të vendimeve; • Pritshmëritë nga ndryshimet në ligjet materiale dhe procedurale. (procedurat civile dhe penale, ligji për Gjykatën Kushtetuese etj.; Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese lidhur me afatin e arsyeshëm); • Kërkimi dhe zbatimi i mjeteve efektive për parandalimin e shkeljeve që lidhen me gjykimin në afat; • Jurisprudenca e GJEDNJ-së lidhur me afatin e arsyeshëm. • Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv; Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit. Shqyrtimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe masa e dëmshpërblimit sipas kritereve të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.”<br>75. 26-27 nëntor 2018 “E drejta e konsumatorit”<br>76. 3-4 dhjetor 2018 “Mbi disa amendime të Kodit të Procedurës Penale – “gjyqtari i seancës paraprake”. Roli i gjyqtarit të seancës paraprake, risitë dhe ecuria e praktikës gjyqësore.”<br>77. 3-4 dhjetor 2018 “Viktima e mitur në procesin penal. I mituri viktimë i veprave penale me natyrë seksuale. Standardet e GJEDNJ-së në lidhje me pyetjen e të miturit dhe përdorimin e deklarimeve të të miturit si provë në procesin penal. Risitë e ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale, si edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. [dita e dytë me OSBE-në me këtë temë] Viktima e mitur e trafikimit dhe shfrytëzimit. Risitë në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në ligjin nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"<br>78. 4 dhjetor 2018 “Të gjesh, të kuptosh dhe citosh praktikën e GJEDNJ-së. Trajtime dhe udhëzime praktike.”<br>79. 4-5 dhjetor 2018 “Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin.”<br>80. 5-6 dhjetor 2018 “Gjykimi në mungesë: Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.01.f | Analiza e nevojave të trajnimit. | *SHM* | | 153.999 lekë | E realizuar | Analiza e nevojave për trajnim është një proces i cili realizohet përgjatë vitit, fillimisht nga sektori i Formimit Profesional, konkretisht, dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, përgjegjësi i sektorit të Formimit Profesional dhe Pedagogu përgjegjës për Programin e Formimit Vazhdues. Për të realizuar këtë analizë të nevojave për trajnim është punuar gjithashtu nga këshilltari akademik dhe Drejtori i Shkollës. Në përmbyllje të procesit është Këshilli Drejtues ai që bën vlerësimin e nevojave dhe vendos lidhur me aktivitetet përkatëse që do të zhvillohen nga shkolla. Kjo analizë nevojash është konsideruar e përmbushur sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë në proces, sipas përqindjeve të caktuara. Pra edhe kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit pagë. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, për 2 muaj në vit (28500 lekë);<br>b) 5% e pagës për përgjegjësin e sektorit të Formimit Profesional, për 1 muaj (4455 lekë);<br>c) 10% e pagës për këshilltarin akademik, për 1 muaj (9975 lekë);<br>d) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës për Formimin |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Vazhdues, për 4 muaj (52749 lekë);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>f) 20% e kostos së 2 mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Shkollës (43800 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën janar-dhjetor 2018 është 153.999 lekë. |
| 3.01.g | Krijimi i kurrikulave / trajnimit pilot. | *SHM* | | 583.000 lekë | E realizuar | Janë krijuar kurrikula për disa trajnime lidhur me këtë objektiv, dhe janë zhvilluar trajnimet si më poshtë:<br><br>1. **12 janar 2018** "Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike. • Kuadri ligjor lidhur me njoftimet me fokus në nenet 133 - 142/a të Kodit të Procedurës Penale; • Njoftimi për herë të parë i të pandehurit të lirë; • Njoftimi i të pandehurit person juridik; • Njoftimi i personave të huaj që gëzojnë imunitet.";<br>2. **19 janar 2018** "Procesverbali i seancës gjyqësore në një procedim penal. • Transkriptimi; • Pavlefshmëritë e akteve. Analizë e dispozitave procedurale penale me fokus në nenet 115-117; 122-130 të Kodit të Procedurës Penale).";<br>3. **9 shkurt 2018** "Njoftimet e veçanta dhe me mjete të tjera teknike.";<br>4. **9 shkurt 2018** "Procesverbali i seancës gjyqësore në një procedim penal.";<br>5. **20-21 mars 2018** "Administrimi efikas i proceseve gjyqësore.";<br>6. **28 – 29 maj 2018** "Mbrojtja e të dhënave private dhe privatësia në raport me lirinë e shprehjes dhe zhvillimet teknologjike";<br>7. **14 – 15 maj 2018** "Zhvillimi i një procesi gjyqësor dhe procesit të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm.";<br>**8. 23-26 tetor 2018** "Metodat e avancuara te trajnimit (Grupi i Punës për Hartimin e Programit të Administrimit të Gjykatës).<br>**9. 13-16 nentor 2018** "Planifikimi Strategjik (grupi i punës për hartimin e programit të administrimit të gjykatës)<br>Numri total i pjesëmarrësve në këto trajnime ka qenë 116 persona.*Aktivitetet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës janë një ose dy ditore të ndara në dy sesione trajnuese (sesioni paradites dhe sesioni pasdites) Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magjistrati në të paktën një sesion trajnues |
| 3.01.h | Fushata të ndërgjegjësimit. | *MD* | | | E parealizuar | Nuk ka asnjë zhvillim për këtë periudhë raportimi. |
| **Aktivitet 3.02** | **Krijimi i një sistemi të arsyeshëm dhe proporcional të tarifave gjyqësore për të siguruar financimin e shërbimeve të drejtësisë, si dhe garantimin e aksesit në gjykatë.** | | | | | |
| 3.02.a | Rishikimi i draftit nën dritën e konsultimit. | *Kuvendi* | 10,000 | | E realizuar | Në fazën e draftimit të tij ligji nr. 98/2017 "Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë" i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimi me institucionet e fushës, ministritë e linjës dhe grupet e interesit etj. Për këtë qëllim janë zhvilluar tryeza konsultimi gjatë të cilave institucione të ndryshme, grupe interesi por edhe gjyqtarë kanë paraqitur komentet dhe opinionet e tyre. Për të analizuar çdo koment të paraqitur për këtë projektligj, u ngrit një grup i përbashkët pune me ekspertë të nivelit të lartë që kanë hartuar draftin, përfaqësues të misionit EURALIUS, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Të gjitha kontributet e dhëna në tryeza dhe/ose të depozituara me shkrim pranë Kuvendit të Shqipërisë u morën në shqyrtim nga grupi i punës dhe u reflektuan në një pjesë të konsiderueshme të tyre me qëllim përgatitjen e një ligji sa më të konsoliduar që balacon të drejtën për akses në drejtësi me nevojën e reformimit të sistemit të tarifave gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.02.b | Miratimi i draftit nga Parlamenti. | *Kuvendi* | | | E realizuar | Kuvendi i Shqipërisë, në datën 2 nëntor 2017 miratoi ligjin Nr.98/2017 "Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë". Disa nga risitë kryesore që ligji për tarifat gjyqësore sjell janë:<br>1) ligji parashikon kategorizimin e tarifave gjyqësore të përgjithshme për paraqitjen e kërkesë-padisë, gjykimin në apel, gjykimin në gjykatën e lartë dhe gjykimin në Gjykatë Kushtetuese.<br>2) Për herë të parë është parashikuar përfshirja e Këshillit të Lartë Gjyqësor në caktimin e llojeve dhe masave të tarifave gjyqësore të përgjithshme, të tarifave gjyqësore shtesë, dhe të masave për llojet e tarifave gjyqësore të veçanta;<br>3) Organet kryesore në caktimin e nivelit të tarifave gjyqësore do të jenë të udhëhequra nga parimi i propocionalitetit, progresivitetit dhe do të bazohen në natyrën e çështjes.<br>4) Caktimi i kufijve minimalë dhe maksimale brenda të cilave do të vepronin tre organet përgjegjëse (MD, MF dhe KLGJ) në caktimin e masës së tarifave gjyqësore;<br>5) Risi kryesore e këtij ligji është përcaktimi i kufijve për tarifat gjyqësore të përgjithshme që do të paguhen gjatë gjykimit në apel dhe Gjykatën e Lartë.<br>6) Nëpërmjet parashikimeve të nenit 9 të ligjit (rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifave gjyqësore), synohet që të garantohet respektimi i plotë i parimit të aksesit në drejtësi.<br>Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 10656, datë 22.11.2017, ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin për tarifat gjyqësore. Kuvendi i Shqipërisë në seancën e plenare të datës 18 dhjetor 2017 miratoi vendimin Nr.114/2017 "Për rrëzimin e dekretit nr. 10 656, datë 22.11.2017, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit nr. 98/2017 "Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë".<br>Ligji 98/2017 "Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë", hyn në fuqi në datë 01.06.2018. |
| **Aktivitet 3.03** | **Krijimi i një sistemi të drejtë dhe funksional të ndihmës juridike falas për individët dhe grupet në nevojë.** | | | | | |
| 3.03.e | Miratimi i draftit nga parlamenti. | *Kuvendi* | | | E realizuar | Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 14.12.2017, miratoi ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Ky ligj sjell risitë e mëposhtme:<br>a) Ristrukturimin e sistemit të ndihmës juridike nëpërmjet transferimit të shqyrtimit të kërkesave për ndihmë juridike dytësore nga Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike tek gjykatat kompetente të cilat operojnë më pranë vendbanimit të subjekteve kërkues.<br>b) Përcaktimin e qartë të kritereve që duhet të përmbushin kërkuesit për përfitimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore.<br>c) Ngritjen dhe zbatimin e një skeme efikase të ndihmës juridike, e cila do të garantojë një akses të shpejtë, të drejtë dhe të rregullt në drejtësi.<br>ç) Sigurimin e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike, veçanërisht për kategoritë në nevojë në përputhje me standartet e përcaktuara në konventat e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.<br>d) Rregullimin ligjor të procedurave të ofrimit të ndihmës juridike nga Organizatat Jofitimprurëse.<br>dh) Përfshirjen e Klinikave Ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë, si ofruese të shërbimeve të ndihmës juridike parësore.<br>e) Qartësimin e kompetencave dhe përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e skemës së shërbimeve të ndihmës juridike.<br>ë) Përcaktimin e një procedure të detajuar të paraqitjes, shqyrtimit dhe ekzekutimit të kërkesave për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.<br>Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", hyn në fuqi në datë 01.06.2018. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.03.f | Fushata e ndërgjegjësimit. | *KLGJ, MD, Dhoma Kombëtare e Avokatisë* | | | Në proces | **KLGJ** u krijua zyrtarisht si institucion në datën 12 Dhjetor 2018. Me krijimin e sistemit të ndihmës juridike, KLGJ do të angazhohet në fushatën e ndërgjegjësimit në periudhën në vijim.<br><br>Për vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të alokuar për këtë qëllim.<br><br>**DHKA:** Është kryer përgatitja dhe shpërndarja e formularëve të aplikimit për ndihmën juridike tek avokatët gjatë muajit dhjetor 2018;<br>•Një seksion i veçantë në formularin e aplikimit i është kushtuar Drejtësisë Penale për të Mitur;<br>•Plotësimi i formularëve nga ana e avokatëve do të kryhet gjatë periudhës së rinovimit të kartave të ushtrimit të profesionit të avokatit me afat deri në fund të Janarit 2019; |
| 3.03.g | Analiza e nevojave të trajnimit. | *SHM (për gjyqtarët), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (avokatët)* | | 153.999 lekë | E realizuar | Analiza e nevojave për trajnim është një proces i cili realizohet përgjatë vitit, fillimisht nga sektori i Formimit Profesional, konkretisht, dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, përgjegjësi i sektorit të Formimit Profesional dhe Pedagogu përgjegjës për Programin e Formimit Vazhdues. Për të realizuar këtë analizë të nevojave për trajnim është punuar gjithashtu nga këshilltari akademik dhe Drejtori i Shkollës. Në përmbyllje të procesit është Këshilli Drejtues ai që bën vlerësimin e nevojave dhe vendos lidhur me aktivitetet përkatëse që do të zhvillohen nga shkolla. Kjo analizë nevojash është konsideruar e përmbushur sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë në proces, sipas përqindjeve të caktuara. Pra edhe kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit pagë. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, për 2 muaj në vit (28500 lekë);<br>b) 5% e pagës për përgjegjësin e sektorit të Formimit Profesional, për 1 muaj (4455 lekë);<br>c) 10% e pagës për këshilltarin akademik, për 1 muaj (9975 lekë);<br>d) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës për Formimin Vazhdues, për 4 muaj (52749 lekë);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>f) 20% e kostos së 2 mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Shkollës (43800 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 153.999 lekë.<br><br>**DHASH:** Me plotësimin e formularëve të aplikimit dhe përzgjedhjes në DHASH do të kryhet dhe një analizë lidhur me nevojat për trajnim të avokatëve, që do të përfshihen në listën e DHASH. Në këtë proces do të mbahet parasysh kombinimi i trajnimeve që do të kryhen për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur me kategoritë e tjera përfituese nga legjislacioni për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. |
| 3.03.h | Krijimi i kurrikulës / trajnimit pilot. | *SHM (për gjyqtarët), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (avokatët)* | | 189.879 lekë | E realizuar | Ndihma juridike falas për individët dhe grupet në nevojë është pjesë e kurrikulës së trajnimit fillestar në lëndën "Menaxhimi i gjykatave dhe i çështjeve të saj dhe administrimi i prokurorisë". Hartimi i kurrikulave është një proces i cili është realizuar nga stafi i brendshëm i shkollës, sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë, sipas përqindjeve të caktuara dhe nga staf i jashtëm në pozicionin e ekspertit në trajnimin vazhdues. Pra kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit page dhe pjesë e pagesës së dhënë ekspertëve për trajimet. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për keshilltarin akademik, për 2 muaj (19942.5 lekë);<br>b) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës, 7 pedagog të brendshëm në Formimin Fillestar, për 1 muaj (61542 lekë);<br>c) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës në Formimin |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Fillestar, për 2 muaj (26375.1 lekë);<br>d) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>e) 30% e 2 mbledhje të Këshillit Drejtues të Shkollës (65700 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 189.879 lekë.<br><br>**DHASH:** Sa i takon trajnimeve për Drejtësinë Penale për të Mitur – kurrikula e trajnimeve është përgatitur në bashkëpunim me Programin HELP të Këshillit të Europës përpara zhvillimit të kursit I online lidhur me Drejtësinë Miqësore për të Miturit, prej të cilit janë trajnuar rreth 30 avokatë nga gjithë Shqipëria, përgjatë vitit 2018. Njoftimi zyrtar për Ministrinë e Drejtësisë do të bëhet nga Këshilli i Europës dhe DHASH lidhur me metodologjinë, temat, si dhe pjesëmarrësit etj;<br>•Zhvillimi i trajnimeve në të gjithë vendin do të kryhet bazuar në aplikimet për drejtësinë penale për të mitur – deadline 31 janar 2019. |
| 3.03.i | Trajnimi i gjyqtarëve dhe stafit administrativ. | *SHM (për gjyqtarët), Dhoma Kombëtare e Avokatisë (avokatët)* | | 99.000 lekë | E realizuar | 1. 19 nëntor 2018 “Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.<br>2. 20 nëntor 2018 ”Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.<br>3. 21 nëntor 2018 “Prezantim i risive të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.<br><br>Numri i pjesëmarrësve në këto trajnimë është 37 persona.<br>*Aktivitetet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës janë një ose dy ditore të ndara në dy sesione trajnuese (sesioni paradites dhe sesioni pasdites) Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magjistrati në të paktën një sesion trajnues. |
| 3.03.new | Buxheti për ndihmën juridike. | *(KLGJ, MD, Dhoma Kombëtare e Avokatisë) KSHNJ* | 0 | 27.350.000 Lekë | E realizuar | Buxheti për vitin 2018, për periudhën janar-dhjetor 2018, për Ndihmën Juridike është në total **27.350.000 Lekë.**<br>Nga ku 4.125.452 lekë buxheti për Paga Shpërblime dhe të tjera, 603.536 lekë kontribut të sig. shoqërore e shëndetsore dhe 20.325.719 lekë buxheti për Mallra dhe Shërbime nga ku 19.765.880 lekë janë shpenzimet kundrejt avokatëve për dhënien e ndihmës juridike falas. |
| **Aktivitet 3.04** | **Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet gjykatës dhe medias dhe sigurimi i aksesit të publikut tek informacioni në rastet e interesit publik.** | | | | | |
| 3.04.f | Krijimi dhe projektimi i faqeve të internetit, mirëmbajtja e faqeve të internetit. | *(KLGJ) KLD, AKSHI* | 0 | | E realizuar për KLD | **KLD** ka vijuar të mirëmbajë dhe përditësojë faqen zyrtare të internetit.<br><br>**KLGJ** u krijua zyrtarisht si institucion në datën 12 Dhjetor 2018. Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet gjykatës dhe medias dhe sigurimi i aksesit të publikut tek informacioni në rastet e interesit publik do të trajtohen me prioritet në vitin 2019.<br><br>Për vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të alokuar për këtë qëllim. |
| 3.04.g | Zbatimi i rregullave të reja për marrëdhëniet me median. | *KLGJ ose institucioni përkatës me ligj* | | | E parealizuar për KLGJ | **KLGJ** u krijua zyrtarisht si institucion në datën 12 Dhjetor 2018. Përmirësimi i marrëdhënieve ndërmjet gjykatës dhe medias dhe sigurimi i aksesit të publikut tek informacioni në rastet e interesit publik do të trajtohen me prioritet në vitin 2019.<br><br>Për vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të alokuar për këtë qëllim. |

## Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.

| Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Institucioni përgjegjës | Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro) | Buxheti i alokuar për çdo aktivitet | Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2018 *(E realizuar/në proces/parealizuar)* | Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Objektivi 4: Rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale dhe masave anti-korrupsion nëpërmjet konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.*** | | | | | | |
| **Aktivitet 4.01** | **Rritja e pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të prokurorëve dhe prokurorisë (sipas standardeve evropiane) duke rishikuar kompetencat e hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykatë dhe duke promovuar kontrollin efektiv dhe ekuilibrin e këtyre kompetencave nga strukturat përgjegjëse.** | | | | | |
| 4.01.a | Hartimi i rregullave dhe manualeve të brendshme. | *MD, PP* | | 346.270 lekë | E realizuar | **PP:** Në muajin tetor 2018 u miratuan:<br>✓ Rregullorja e Prokurorisë së Përgjithshme;<br>✓ Udhëzimi i përgjithshëm "Mbi Përgjimet";<br>✓ Udhëzim "Për koordinimin në çështjet e ekstradimit për jashtë shtetit";<br><br>Kosto administrative llogaritet afërsisht 346.270 lekë. |
| 4.01.b | Analiza e nevojave për trajnim. | *MD, PP* | | | E realizuar | Në nivel institucional është bashkëpunuar me projektet që asistojnë prokurorinë për zhvillimin e trajnimeve fokusuar kryesisht në kuptimin e ndryshimeve ligjore në kuadër të reformës në drejtësi.<br>Opdat ka zhvilluar trajnime lidhur ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit për prokurorinë në kuadër të garantimit të asistences ndaj viktimave;<br>Pameca V ka organizuar trajnime lidhur me seancën paraprake; krimin kompjuterik; ligjin antimafia etj.<br><br>EURALIUS gjatë vitit 2018 në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës ka organizuar trajnime mbi disa amendime të Anti-Mafia, (datë 1 dhe 2 Nëntor 2018); Prezantim i risive të Ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" (data 19-21 Nëntor 2018); - Trajnim mbi disa amendime të Kodit të Procedurës Penale – "gjyqtari i seancës paraprake" (data 3-4 Dhjetor 2018).<br><br>Nga ana tjetër, në zbatim të ligjit 115/2016, prokurorët i drejtojnë drejtëperdrejtë nevojat për trajnim Shkollës së Magjistraturës. |
| 4.01.c | Krijimi i kurrikulave / trajnimit pilot. | *MD, PP* | | | E parealizuar | Për periudhën janar – dhjetor 2018 nuk ka zhvillime. |
| 4.01.d | Fushata sensibilizuese | *MD, PP* | | 150.000 lekë | E realizuar | **PP:** Në muajin Tetor 2018 u miratua udhëzimi "Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale". Pjesë e tij është edhe një broshurë informative dhe ndihmuese. Kjo broshurë është shpërndarë në prokuroritë e shkallës së parë dhe është përfshirë në faqen zyrtare të prokurorisë.<br><br>Kosto e hartimit dhe konsultimit të aktit llogaritet afërsisht 150.000 lekë. |
| **Aktivitet 4.02** | **Krijimi i një strukture të specializuar anti-korrupsion në nivel kombëtar, të përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykata.** | | | | | |
| 4.02.b | Hartimi i një strukture të re organizative dhe kostot përkatëse<br>Manual<br>Rekrutimi i stafit<br>Shpenzime operative | *KLGJ, KLP, SPAK* | 1,150,000<br>214,285 | | Në proces | KLGJ u krijua zyrtarisht si institucion në datën 12 Dhjetor 2018. Megjithatë, duke e konsideruar si një ndër çështjet më prioritare, në mbledhjen e datës 27.12.2018 Këshilli i Lartë Gjyqësor, shqyrtoi me prioritet funksionimin e Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe emërimin e kandidatëve për magjistratë të diplomuar nga Shkolla e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (shpenzime për staf mbështetës). | | | | | Magjistraturës.<br><br>Në përputhje me kompetencat e përcaktura nga ligji, Këshilli vendosi nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duke i hapur rrugë krijimit të këtyre gjykatave.<br><br>Gjithashtu nisi procesi i komunikimit me institucionet shtetërore kompetente për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për magjistratë të diplomuar në vitin 2018.<br><br>Për vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të alokuar për këtë qëllim. |
| 4.02.c | Kontrollet e sigurisë për gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore. | *KLGJ, KLP, SPAK* | | | E parealizuar | Në varësi të aktivitetit 4.02.b. |
| 4.02.d | Analiza e nevojave të trajnimit.<br>Sistemi elektronik funksional. | *SHM, KLGJ, KLP, SPAK* | 1,000,000 | 153.999 lekë | E realizuar | Analiza e nevojave për trajnim është një proces i cili realizohet përgjatë vitit, fillimisht nga sektori i Formimit Profesional, konkretisht, dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, përgjegjësi i sektorit të Formimit Profesional dhe Pedagogu përgjegjës për Programin e Formimit Vazhdues. Për të realizuar këtë analizë të nevojave për trajnim është punuar gjithashtu nga këshilltari akademik dhe Drejtori i Shkollës. Në përmbyllje të procesit është Këshilli Drejtues ai që bën vlerësimin e nevojave dhe vendos lidhur me aktivitetet përkatëse që do të zhvillohen nga shkolla. Kjo analizë nevojash është konsideruar e përmbushur sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë në proces, sipas përqindjeve të caktuara. Pra edhe kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit pagë. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, për 2 muaj në vit (28500 lekë);<br>b) 5% e pagës për përgjegjësin e sektorit të Formimit Profesional, për 1 muaj (4455 lekë);<br>c) 10% e pagës për këshilltarin akademik, për 1 muaj (9975 lekë);<br>d) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës për Formimin Vazhdues, për 4 muaj (52749 lekë);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>f) 20% e kostos së 2 mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Shkollës (43800 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 153.999 lekë. |
| 4.02.f | Trajnimi i anëtarëve të SPAK dhe stafit administrativ.<br>Krijimi i kurrikulave / trajnimit pilot. | *SHM* | | 1.091.750 lekë | E realizuar | Për shkak të moskostituimit të organeve të Prokurorisë së Posaçme, Shkolla e Magjistraturës ka zhvilluar disa aktivitete trajnuese për anti korrupsionin me gjyqtarë dhe prokurorë, konkretisht:<br><br>1. **12 janar 2018** "Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale.";<br>2. **30-31 janar 2018** "Bashkëpunimi ndërinstitucional në procesin e hetimit dhe gjykimit të veprave penale. • Roli i Policisë Shkencore; • Bashkëpunimi i gjyqësorit dhe prokurorisë me Policinë Shkencore.";<br>3. **28 mars 2018** "Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale.;<br>4. **16-17 maj 2018** "Veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit.";<br>5. **20 - 21 qershor 2018** "Hetimet proaktive në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.";<br>6. **27- 28 qershor 2018** "Grupi i strukturuar kriminal, si formë e veçantë bashkëpunimi.".<br>7. **1-2 nëntor 2018** "Mbi disa amandime të ligjit nr. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" (Ligji antimafia)";<br>8. **12-13 nëntor 2018** "Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve."<br>9**. 3-4 dhjetor 2018** "Viktima e mitur në procesin penal. I mituri viktimë i veprave penale me natyrë seksuale. Standardet e GJEDNJ-së në lidhje me pyetjen e të miturit dhe përdorimin e deklarimeve të të miturit si provë në procesin penal. Risitë e ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale, si edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. [dita e dytë me OSBE-në me këtë temë] Viktima e mitur e trafikimit dhe shfrytëzimit. Risitë në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në ligjin nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".<br>Pjesëmarrja në total në këto trajnime ka qenë 227 persona. *Aktivitetet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës janë një ose dy ditore të ndara në dy sesione trajnuese (sesioni paradites dhe sesioni pasdites) Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magjistrati në të paktën një sesion trajnues. |
| **Aktivitet 4.03** | **Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale dhe zbatimi i tyre, për ta sjellë atë në përputhje me standardet evropiane.** | | | | | |
| 4.03.c | Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për amendamentet e Kodit të Procedurës Penale. | *MD* | | | E parealizuar | Nuk ka asnjë zhvillim për këtë periudhë raportimi. |
| 4.03.d | Analiza e nevojave të trajnimit. | *SHM* | | 153.999 lekë | E realizuar | Analiza e nevojave për trajnim është një proces i cili realizohet përgjatë vitit, fillimisht nga sektori i Formimit Profesional, konkretisht, dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, përgjegjësi i sektorit të Formimit Profesional dhe Pedagogu përgjegjës për Programin e Formimit Vazhdues. Për të realizuar këtë analizë të nevojave për trajnim është punuar gjithashtu nga këshilltari akademik dhe Drejtori i Shkollës. Në përmbyllje të procesit është Këshilli Drejtues ai që bën vlerësimin e nevojave dhe vendos lidhur me aktivitetet përkatëse që do të zhvillohen nga shkolla. Kjo analizë nevojash është konsideruar e përmbushur sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë në proces, sipas përqindjeve të caktuara. Pra edhe kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit pagë. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, për 2 muaj në vit (28500 lekë);<br>b) 5% e pagës për përgjegjësin e sektorit të Formimit Profesional, për 1 muaj (4455 lekë);<br>c) 10% e pagës për këshilltarin akademik, për 1 muaj (9975 lekë);<br>d) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës për Formimin Vazhdues, për 4 muaj (52749 lekë);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>f) 20% e kostos së 2 mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Shkollës (43800 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 153.999 lekë. |
| 4.03.e | Krijimi i kurrikulave / trajnimit pilot. | *SHM* | | 188.079 lekë | E realizuar | Hartimi i kurrikulave është një proces i cili është realizuar nga stafi i brendshëm i shkollës, sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë, sipas përqindjeve të caktuara dhe nga staf i jashtëm në |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | pozicionin e ekspertit në trajnimin vazhdues. Pra kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit page dhe pjesë e pagesës së dhënë ekspertëve për trajimet. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për keshilltarin akademik, për 2 muaj (19942.5 lekë);<br>b) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës, 7 pedagog të brendshëm në Formimin Fillestar, për 1 muaj (61542 lekë);<br>c) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës në Formimin Fillestar, për 2 muaj (26375.1 lekë);<br>d) 4 orë për cdo aktivitet trajnues për ekspertët në përmbushje të detyrimit të tyre për përgatitje për aktivitetin trajnues (llogaritjen në lekë e përfshijmë në koston totale të aktivitetit trajnues);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>f) 30% e 2 mbledhje të Këshillit Drejtues të Shkollës (65700 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 188.079 lekë. |
| 4.03.f | Trajnimi i gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe stafit administrativ. | *SHM* | | 3.365.500 lekë | E realizuar | Shkolla e Magjistraturës vijon të organizojë trajnime me këtë tematikë për shkak të interesit të lartë. Konkretisht:<br><br>1. **10-11 janar 2018** “Rishikimi i vendimit të formës së prerë në Procesin Penal. Risitë e Kodit Procedural Penal (neni 449, 450, i ndryshuar i KPP-së). • Zbatimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si shkak i domosdoshëm për rigjykimin e çështjes dhe rishikimin e vendimit të formës së prerë penale..”;<br>2. **24-25 janar 20**18 “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. • Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; • Kerkesa per gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmerite e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjate kesaj seance. • Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake; Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbesore te saj- detyrueshmeria dhe pakthyeshmeria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.”;<br>3. **29-30 janar 2018** “Padia civile në procesin penal. • Risitë e Kodit të Procedurës Penale lidhur me padinë civile në procesin penal; •Problematika e praktikës gjyqësore lidhur me padinë civile në procesin penal.”;<br>4. **19-20 shkurt 2018** “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.”;<br>5. **12-13 mars 2018** “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.”;<br>6. **28 mars 2018** “I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe risitë që sjellin ndryshimet e KPP-së.”;<br>7. **12-13 prill 2018** “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake. • Roli i prokurorit në drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake; • Kerkesa per gjykim e prokurorit dhe seanca paraprake. Pavlefshmerite e akteve dhe shqyrtimi i tyre gjate kesaj seance. • Kontrolli gjyqësor gjatë fazës së hetimeve paraprake; Kontrolli juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Karakteristikat thelbesore te saj- detyrueshmeria dhe pakthyeshmeria. Kontrolli mbi mosushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori. Raporti i prokurorit me policinë gjyqësore, veprimet me iniciativë dhe ato të deleguara.”;<br>8. **24 – 25 prill 2018** “I pandehuri i penduar si bashkëpunëtor i drejtësisë.Pozicioni procedural i të pandehurit bashkëpunëtor i drejtësisë si "dëshmitar" në proces; Rëndësia dhe roli i dëshmitarit me identitet të fshehur në procedimin penal; Vlera provuese e deklarimeve.”;<br>9. **3 – 4 maj 2018** “I pandehuri i penduar si bashkëpunëtor i drejtësisë. Pozicioni procedural i të pandehurit bashkëpunëtor i drejtësisë si "dëshmitar" në proces; Rëndësia dhe roli i dëshmitarit me identitet të fshehur në procedimin penal; Vlera provuese e deklarimeve.”; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 10. **8 maj 2018** “I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe risitë që sjellin ndryshimet e KPP-së.”;<br>11. **28 – 29 maj 2018** “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake”;<br>12. **6 – 7 qershor 2018** “Rishikimi i vendimit të formës së prerë në Procesin Penal. Risitë e Kodit Procedural Penal (neni 449, 450, i ndryshuar i KPP-së). Zbatimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si shkak i domosdoshëm për rigjykimin e çështjes dhe rishikimin e vendimit të formës së prerë penale.”;<br>13. **13 – 14 qershor 2018** “I pandehuri i penduar si bashkëpunëtor i drejtësisë”;<br>14. **18 – 19 qershor 2018** “Padia civile në procesin penal. Risitë e Kodit të Procedurës Penale lidhur me padinë civile në procesin penal; Problematika e praktikës gjyqësore lidhur me padinë civile në procesin penal.”;<br>15. **25 qershor 2018** “I pandehuri, mbrojtësi i tij dhe risitë që sjellin ndryshimet e KPP-së”;<br>16. **28 – 29 qershor 2018** “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake”.<br>17. **28 – 29 qershor 2018** “Raporti prokurori - gjykatë për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake”.<br>18. **15-16 tetor 2018** “Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin.”<br>19. **25-26 tetor 2018** “Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit.”<br>20. **26 tetor 2018** “Investigimi i rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve;”<br>21. **31 tetor 2018** “Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave;”<br>22. **1-2 nëntor 2018** “Mbi disa amandime të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (Ligji antimafia)”<br>23. **5-6 nëntor 2018** “Ankimi kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës, në rastin e kundërvajtjeve penale. Roli i gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe i seancës paraprake dhe problemet e praktikës gjyqësore;”<br>24. **7-8 nëntor 2018** “Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit.”<br>25. **9 nëntor 2018** “Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave;”<br>26. **12-13 nëntor 2018** “Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve.”<br>27. **12-13 nëntor 2018** “Provat dhe papërdorshmëria e provave të marra në kundërshtim me ligjin. Raporti i aktit të pavlefshëm me përdorshmërinë e provës së marrë nëpërmjet tij. Këndvështrim krahasues me doktrinën dhe jurisprudencën e huaj.”<br>28. **14-15 nëntor 2018** “Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal. • Kujdesi për ruajtjen e balancës me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Rezultatet e përgjimit dhe vlera provuese. Praktika gjyqësore dhe standardet ndërkombëtare.”<br>29. **21-22 nëntor 2018** “Integriteti i zyrtarëve të agjencive ligjzbatuese dhe lufta kundër korrupsionit. Korrupsioni i funksionarëve të lartë të drejtësisë dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë.”<br>30. **3-4 dhjetor 2018** “Mbi disa amendime të Kodit të Procedurës Penale – “gjyqtari i seancës paraprake”.<br>31. **3-4 dhjetor 2018** “Viktima e mitur në procesin penal. I mituri viktimë i veprave penale me natyrë seksuale. Standardet e GJEDNJ-së në lidhje me pyetjen e të miturit dhe përdorimin e deklarimeve të të miturit si |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | provë në procesin penal. Risitë e ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale, si edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. [dita e dytë me OSBE-në me këtë temë] Viktima e mitur e trafikimit dhe shfrytëzimit. Risitë në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në ligjin nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".<br>32. **4-5 dhjetor 2018** "Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin."<br>33. **5-6 dhjetor 2018** "Gjykimi në mungesë: Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;"<br>34. **7 dhjetor 2018** "Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave;"<br>35. **13-14 dhjetor 2018** "Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit."<br>36. **19-20 dhjetor 2018** "Të Drejtat e Njeriut dhe biomjekësia."<br><br>Pjesëmarrës në këto trajnime kanë qenë 818 persona.. Aktivitetet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës janë një ose dy ditore të ndara në dy sesione trajnuese (sesioni paradites dhe sesioni pasdites) Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magjistrati në të paktën një sesion trajnues.<br>Kosto totale për këto trajnime ka qenë 3.365.500 lekë. |
| **Aktivitet 4.04** | **Përmirësimi i legjislacionit penal në përputhje me standardet evropiane.** | | | | | |
| 4.04.b | Përfundimi i amendimeve të kodit të procedurës penale dhe kodit penal. | *Kuvendi* | | | E realizuar | Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në datë 30.03.2017 **ligjin nr.35/2017** "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" dhe **ligjin nr.36/2017** "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".<br>*Risitë e ndryshimeve ligjore të miratuar në Kodin e Procedurës Penale konsistojnë në:*<br>a) Mbrojtjen më të mirë të viktimave në procesin penal;<br>a) Garantimin e instrumenteve procedurale dhe afate të arsyeshme për zhvillimin e veprimeve hetimore, në pajtim me kompleksitetin e çështjes;<br>b) Zhvillimin e gjykimit në mënyrë të pandërprerë;<br>c) Rritjen e autoritetit të gjykatës në disiplinimin dhe zhvillimin normal të gjykimit penal;<br>d) Rregullimin dhe bërjen efektive të gjykimit të drejtpërdrejtë, rregullimi i procedurës së gjykimit të shkurtuar;<br>dh) Parashikimi i dy insituteve të reja të gjykimeve të posaçme që synon shkurtimin e shpenzimeve gjyqësore dhe uljen e ngarkesës në punë të gjykatave dhe prokurorive.<br>e) Parashikimin e mekanizmave të nevojshëm ligjorë që mundësojnë pjesëmarrjen e të pandehurit dhe/ose avokatit të tij mbrojtës në gjykim për të shmangur gjykimin në mungesë, si gjoba dhe zëvendësimi ex officio i avokatit nga gjykata;<br>f) Përmirësimin e rregullimeve për njoftimin e palëve;<br>h) Përmirësimin e rregullimeve në lidhje me ankimet, që do të përshpejtojnë gjykimin dhe ulin ngarkesën e gjykatës së apelit.<br>i) Reflektimi i ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore që lidhen me kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe rregullimin e marrëdhënieve mes Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm.<br>j) Rishikimi i dispozitave që rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale me jashtë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | *Ndryshimet e miratuara në Kodin Penal synojnë:*<br>1- Harmonizimi me ligjet e tjera që veprojnë në fushën e drejtësisë penale si dhe reflektimi i disa rregullime për dënimin e të miturve sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.<br>2- Përcaktime më të qarta në dispozitat që parashikojnë aplikimin e dënimeve alternative si pezullimi të ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim apo të lirimit para kohe me kusht.<br>3- Rregullimin e institutit të parashkrimit të ndjekjes penale, duke pakësuar mundësinë e autorëve të veprave penale më rrezikshmëri të theksuar shoqërore për t'u shmangur ndjekjes penale.<br>4-Saktësimi i kuptimit dhe përmbajtjes e disa dispozitave të Kodit Penal aktual për zbatimin më të drejtë në praktikën hetimore dhe gjyqësore. |
| 4.04.c | Konsultimi për kodet. | *Kuvendi* | | | E realizuar | Procesi i hartimit dhe konsultimit të ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar" dhe ligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar" ka respektuar parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit të gjerë midis gjithë aktorëve në këtë proces.<br>Ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale gjatë fazës së konsultimit, iu nënshtruan diskutimit publik, me pjesëmarrje të gjerë, nga radhët e profesionistëve, përfaqësuesve të institucioneve, përfaqësues të gjykatave të të gjitha niveleve, prokurorë, avokatë, përfaqësues të botës akademike, përfaqësues të shoqërisë civile etj. Ligjet janë diskutuar edhe në tryeza publike të organizuara për këtë qëllim. Tryezat e konsultimit sollën një diskutim të gjerë e mjaft të dobishëm mbi ndryshimet e propozuara në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Penal. Gjithashtu institucione si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, gjyqtarë, prokurorë dhe nga organizata ndërkombëtarë OPDAT, si dhe organizata të shoqërisë civile kanë dërguar komente dhe sugjerime e tyre për përmbajtjen e ligjeve. Pas komenteve të ardhura u konstatua nevoja për të ripunuar draftin e përcjellë, për të reflektuar komentet e sugjerimet dhe njëkohësisht për ta harmonizuar atë me legjislacionin në fuqi. Grupi i Punës gjatë ripunimit të tyre është asistuar nga ekspertë të misionit EURALIUS dhe OPDAT. |
| 4.04.d | Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për Kodin e ri Penal. | *MD* | | | E parealizuar | Nuk ka asnjë zhvillim për këtë periudhë raportimi. |
| 4.04.f | Analiza e nevojave për trajnim.<br>Ofrimi i komentarëve për kodin e ri. | *SHM, MD* | | 153.999 lekë | E realizuar | Analiza e nevojave për trajnim është një proces i cili realizohet përgjatë vitit, fillimisht nga sektori i Formimit Profesional, konkretisht, dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, përgjegjësi i sektorit të Formimit Profesional dhe Pedagogu përgjegjës për Programin e Formimit Vazhdues. Për të realizuar këtë analizë të nevojave për trajnim është punuar gjithashtu nga këshilltari akademik dhe Drejtori i Shkollës. Në përmbyllje të procesit është Këshilli Drejtues ai që bën vlerësimin e nevojave dhe vendos lidhur me aktivitetet përkatëse që do të zhvillohen nga shkolla. Kjo analizë nevojash është konsideruar e përmbushur sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë në proces, sipas përqindjeve të caktuara. Pra edhe kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit pagë. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për dy sekretare shkencore të Formimit Vazhdues, për 2 muaj në vit (28500 lekë);<br>b) 5% e pagës për përgjegjësin e sektorit të Formimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Profesional, për 1 muaj (4455 lekë);<br>c) 10% e pagës për këshilltarin akademik, për 1 muaj (9975 lekë);<br>d) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës për Formimin Vazhdues, për 4 muaj (52749 lekë);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>f) 20% e kostos së 2 mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Shkollës (43800 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 153.999 lekë. |
| 4.04.g | Vendosja e kurrikulave / trajnimit pilot. | *SHM* | | 188.079 lekë | E realizuar | Hartimi i kurrikulave është një proces i cili është realizuar nga stafi i brendshëm i shkollës, sipas përshkrimit të punës së personave të përfshirë, sipas përqindjeve të caktuara dhe nga staf i jashtëm në pozicionin e ekspertit në trajnimin vazhdues. Pra kosto e këtij procesi ka qenë pjesë e fondit page dhe pjesë e pagesës së dhënë ekspertëve për trajimet. Konkretisht:<br>a) 10% e pagës për keshilltarin akademik, për 2 muaj (19942.5 lekë);<br>b) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës, 7 pedagog të brendshëm në Formimin Fillestar, për 1 muaj (61542 lekë);<br>c) 10% e pagës për pedagogun përgjegjës në Formimin Fillestar, për 2 muaj (26375.1 lekë);<br>d) 4 orë për cdo aktivitet trajnues për ekspertët në përmbushje të detyrimit të tyre për përgatitje për aktivitetin trajnues (llogaritjen në lekë e përfshijmë në koston totale të aktivitetit trajnues);<br>e) 10% e pagës për Drejtorin e Shkollës, për 1 muaj (14520 lekë);<br>f) 30% e 2 mbledhje të Këshillit Drejtues të Shkollës (65700 lekë).<br><br>Kosto totale për periudhën është 188.079 lekë. |
| 4.04.h | Trajnimi i gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe stafit administrativ. | *SHM* | | 4.757.000 lekë | E realizuar | Shkolla e Magjistraturës i kushton shumë rëndësi analizimit të legjislacionit shqiptar bazuar në standardet evropiane. Aktivitet trajnuese të realizuara për periudhën janë si më poshtë:<br><br>1. **8-9 janar 2018** “Veprat penale në kushtet e tronditjes psikike. Vështrim krahasues me mbrojtjen e nevojshme dhe të drejtën ndërkombëtare penale.”;<br>2. **8-9 janar 2018** “Masat e sigurimit personal. • Roli i gjykatës në kërkesat e bëra për zëvendësimin e tyre në raport me mendimin e prokurorit; • Zbatimi i më shumë se një mase sigurimi personal dhe i dënimeve alternative me qëllim uljen e rasteve të zbatimit të masës së sigurisë “arrest me burg” dhe dënimit me burgim; • Përzgjedhja dhe zbatimi i masave të Sigurimit Personal, ndaj të miturve në konflikt me ligjin analizë e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit; • Seanca e vlerësimit për masën e sigurimit.”;<br>3. **18-19 janar 2018** “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. • Trajtimi integral i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm; • Standardi i GJEDNJ-së për ekzekutimin e vendimeve dhe kohëzgjatjen e gjykimit. Përshpejtimi në rastet e vonesave dhe ngritja e një mekanizmi efektiv; Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës së Strasburgut dhe Luksemburgut në planin e përgjithshëm. Detyrat e vëna për Shqipërinë në veçanti. • Kontrolli gjyqësor mbi ekzekutimet; • Masat e sigurimit civil të padisë. Praktika gjyqësore dhe ajo unifikuese në lidhje me masat e sigurimit të padisë. Ankimi në rastin e rrëzimit të masës së sigurimit; • Aplikimi për rastet e procedurave përmbarimore për |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | ekzekutimin e kontratave të kredive bankare; •Veçimi i pjesës së debitorit bashkëpronar në fazën e ekzekutimit të detyrimeve dhe problemet e lindura në praktikën gjyqësore.”;<br>4. **22-23 janar 2018** “Hetimet proaktive në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. • Forcimi i koordinimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit; • Zvogëlimi i kërcënimeve të terrorizmit nëpërmjet vlerësimit të rrezikut, duke bashkëpunuar me strukturat e shtetit të angazhuara në këtë fushë; • Bashkëpunimi ndërkombëtar në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Luftëtarët terroristë të huaj. Standardet ndërkombëtare lidhur me kriminalizimin e veprave penale të kryera prej tyre; Vështrim krahasues me legjislacionin penal shqiptar; Metodologjia hetimore dhe problemet e ndeshura në praktikë.”;<br>5. **1-2 shkurt 2018** “Grupi i strukturuar kriminal, si formë e veçantë bashkëpunimi.”;<br>6. **1-2 shkurt 2018** “Vepra penale e shpifjes.”;<br>7. **5-6 shkurt 2018** “Masat e sigurimit personal.”;<br>8. **7-8 shkurt 2018** “Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit me fokus: • Trafikimin e qenieve njerëzore. Specifikat që paraqesin subjektet e veçanta. Teknikat e hetimit proaktiv, trajtimin e viktimave gjatë gjithë procedimit penal si dhe trafikimi i fëmijëve, duke u përqendruar te format e reja të këtij trafikimi. Dallimi mes kësaj figure vepre penale dhe veprave të tjera të ngjashme me to, p.sh.: shfrytëzimi i fëmijëve për lypje etj.; • Trafikimin e armëve e municioneve luftarake; • Trafikimin e mjeteve motorike dhe veprave të artit e të kulturës; • Rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional mes institucioneve ligjzbatuese.”;<br>9. **12-13 shkurt 2018** “Teknikat e posaçme të hetimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe kuadrit ligjor shqiptar. Trajtesë teorike dhe praktike.• Metodat speciale të hetimit; • Veprimet simuluese; • Roli i punonjësit të infiltruar të policisë dhe Jurisprudenca e GJEDNJ-së; • Bashkëpunëtori i drejtësisë dhe dëshmitari me identitet të fshehur.”;<br>10. **14-15 shkurt 2018** “Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja. • Ekstradimi; • Arresti i përkohshëm; • Njohja e vendimit penal të huaj për të gjykuarin në mungesë "in absentia" nga Autoriteti Gjyqësor i Huaj.”;<br>11. **19-20 shkurt 2018** “Krimi ndërkufitar dhe trafiqet e paligjshme • Forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafiqeve të paligjshme; • Rritja e standardeve të sigurisë së kufijve në parametrat e vendeve të BE-së. • Bashkëpunimi ndërkufitar dhe hetimet e përbashkëta si element kyç i luftës ndaj këtij fenomeni.”;<br>12. **26-27 shkurt 2018** “Gjykimi në mungesë. Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; • Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor në praninë e të pandehurit në gjykim; • Legjislacioni shqiptar dhe probleme të praktikës gjyqësore shqiptare.”;<br>13. **5-6 mars 2018** “Masat e sigurimit personal.”;<br>14. **7-8 mars 2018** “Gjykimi në mungesë.”;<br>15. **9 mars 2018** “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal.”;<br>16. **15-16 mars 2018** “Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal.”;<br>17. **23 mars 2018** “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal.”;<br>18. **26-27 mars 2018** “Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.”; 19.<br>**30 mars 2018** “Të drejtat e viktimës në dhe gjatë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | procesit penal.";<br>20. **4 – 5 prill 2018** "Gjykimi në mungesë. Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me fokus kryesor në praninë e të pandehurit në gjykim; Legjislacioni shqiptar dhe probleme të praktikës gjyqësore shqiptare";<br>21. **6 prill 2018** "Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal; Roli i viktimës në seancën paraprake; Roli i viktimës gjatë gjykimit; Riviktimizimi; Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjykimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?.";<br>22. **13 prill 2018** "Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal; Roli i viktimës në seancën paraprake; Roli i viktimës gjatë gjykimit; Riviktimizimi; Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjykimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?.";<br>23. **20 prill 2018** "Të drejtat e viktimës në dhe gjatë procesit penal. Standardet e BE-së mbi të drejtat e viktimës dhe të të pandehurit në procesin penal; Roli i viktimës në seancën paraprake; Roli i viktimës gjatë gjykimit; Riviktimizimi; Mjetet procedurale për mosmarrjen e dëshmisë së përsëritur gjatë proceseve gjyqësore. Paragjykimet: indikator në komunikimin dhe trajtimin e viktimave. Llojet e paragjykimeve dhe ndikimi i tyre në komunikimin verbal dhe joverbal. Si janë krijuar qëndrimet, vlerat, besimet? Si ndërhyjnë këto në komunikim me njerëzit që punojmë? Si reflektohen në qëndrimet që mbahen me rastet që punojmë? Si ndikojnë në cilësinë e punës si gjyqtar apo prokuror?.";<br>24. **26 – 27 prill 2018** "Veprat penale në kushtet e tronditjes psikike. Vështrim krahasues me mbrojtjen e nevojshme dhe të drejtën ndërkombëtare penale.";<br>25. **23 – 24 maj 2018** "Mbrojtja nga dhuna në familje në aspektin civil dhe penal. Problemet e praktikës ligjore në rastet e urdhrit të mbrojtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes; Rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 9669/2006 dhe subjekteve të mbrojtura nga neni 130/a të Kodit të Familjes; Trajtimi i rrethanave cilësuese të nenit 130/a të Kodit Penal.";<br>26. **11 – 12 qershor 2018** "Mbrojtja nga dhuna në familje në aspektin civil dhe penal. Problemet e praktikës ligjore në rastet e urdhrit të mbrojtjes dhe urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes; Rrethi i subjekteve që gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 9669/2006 dhe subjekteve të mbrojtura nga neni 130/a të Kodit të Familjes; Trajtimi i rrethanave cilësuese të nenit 130/a të Kodit Penal."; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 27. **30 – 31 maj 2018** "Krimi kibernetik. Evidentimi i krimit kibernetik; Procedimi Penal në rastet e krimit kibernetik: dëshmitë elektronike; Të ardhurat nga krimi online; Përdorimi i internetit për qëllime terroriste."; <br>28. **18 – 19 qershor 2018** "Krimi kibernetik. Evidentimi i krimit kibernetik; Procedimi Penal në rastet e krimit kibernetik: dëshmitë elektronike; Të ardhurat nga krimi online; Përdorimi i internetit për qëllime terroriste." <br>29. **2 - 3 Korrik 2018** "Caktimi i dënimit penal nga gjykata. Kriteret e caktimit të dënimit me fokus në nenin 47 dhe vijues të Kodit Penal. Trajtesa teorike dhe praktika gjyqësore lidhur me caktimin e dënimit penal nga gjykata. Caktimi i dënimit për veprën penale të mbetur në tentativë, për personat e dehur dhe ata me probleme të shëndetit mendor; Personat me probleme të shëndetit mendor: mirëqenia mendore: kuptimi; promovimi i mirëqenies mendore; stresi dhe menaxhimi i tij. Caktimi i dënimit në rastin e njohjes së një vendimi të një gjykate të huaj"; <br>30. **15-16 tetor 2018** "Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin." <br>31. **25-26 tetor 2018** "Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit." <br>32. **26 tetor 2018** "Investigimi i rasteve që lidhen me sigurinë e gazetarëve;" <br>33. **31 tetor 2018** "Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave;" <br>34. **1-2 nëntor 2018** "Mbi disa amandime të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" (Ligji antimafia)" <br>35. **5-6 nëntor 2018** "Ankimi kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës, në rastin e kundërvajtjeve penale. Roli i gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe i seancës paraprake dhe problemet e praktikës gjyqësore;" <br>36. **7-8 nëntor 2018** "Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit." <br>37. **9 nëntor 2018** "Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave;" <br>38. **12-13 nëntor 2018** "Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve." <br>39. **12-13 nëntor 2018** "Provat dhe papërdorshmëria e provave të marra në kundërshtim me ligjin. Raporti i aktit të pavlefshëm me përdorshmërinë e provës së marrë nëpërmjet tij. Këndvështrim krahasues me doktrinën dhe jurisprudencën e huaj." <br>40. **14-15 nëntor 2018** "Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal. • Kujdesi për ruajtjen e balancës me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Rezultatet e përgjimit dhe vlera provuese. Praktika gjyqësore dhe standardet ndërkombëtare." <br>41. **21-22 nëntor 2018** "Integriteti i zyrtarëve të agjencive ligjzbatuese dhe lufta kundër korrupsionit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Korrupsioni i funksionarëve të lartë të drejtësisë dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë."<br>42. **3-4 dhjetor 2018** "Mbi disa amendime të Kodit të Procedurës Penale – "gjyqtari i seancës paraprake".<br>43. **3-4 dhjetor 2018** "Viktima e mitur në procesin penal. I mituri viktimë i veprave penale me natyrë seksuale. Standardet e GJEDNJ-së në lidhje me pyetjen e të miturit dhe përdorimin e deklarimeve të të miturit si provë në procesin penal. Risitë e ndryshimeve ligjore në Kodin e Procedurës Penale, si edhe në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. [dita e dytë me OSBE-në me këtë temë] Viktima e mitur e trafikimit dhe shfrytëzimit. Risitë në Kodin e Procedurës Penale, në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe në ligjin nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".<br>44. **4-5 dhjetor 2018** "Drejtësia penale për të mitur, fëmijët në konflikt me ligjin."<br>45. **5-6 dhjetor 2018** "Gjykimi në mungesë: Gjykimi në mungesë sipas nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;"<br>46. **7 dhjetor 2018** "Viktima dhe procesi penal. Ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare. Mbrojtja nga riviktimizimi. Probleme të padisë civile në procesin penal. Dëmshpërblimi i viktimave;"<br>47. **13-14 dhjetor 2018** "Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit."<br>48. **19-20 dhjetor 2018** "Të Drejtat e Njeriut dhe biomjekësia."<br><br>Pjesëmarrës në total në këto trajnime janë 818 persona.<br>*Aktivitetet trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës janë një ose dy ditore të ndara në dy sesione trajnuese (sesioni paradites dhe sesioni pasdites) Një pjesëmarrje cilësohet prania fizike e një magjistrati në të paktën një sesion trajnues. |
| **Aktivitet 4.05.** | **Forcimi i kapaciteteve të Prokurorisë së Përgjithshme që të realizojë në mënyrë sa më efektive procesin e dekriminalizimit siç përcaktohet në ligj.** | | | | | |
| 4.05.b | Punësimi i 2 prokurorëve dhe i 2 nëpunësve civilë. | *PP* | 59,649 | | E realizuar | Prej marsit 2016 brenda numrit të punonjësve është ngritur dhe funksionon sektori i verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike. |
| 4.05.c | Hartimi i kurrikulave dhe trajnim i stafit. | *PP* | | | E parealizuar | Për periudhën janar - dhjetor 2018 nuk ka zhvillime. |
| 4.05.d | Sigurimi i pajisjeve. | *PP* | | | E realizuar | Punonjësve u janë siguruar pajisjet e nevojshme të zyrës. |
| **Aktivitet 4.06** | **Mbështetje për strategjinë e përgjithshme anti-korrupsion brenda Ministrisë dhe sistemit të drejtësisë për të arritur tek një nivel i performancës organizative në përputhje me standardet europiane.** | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.06.e re1 | Analiza e nevojave për trajnim. | *MD* | | | E realizuar | Analiza e nevojave për trajnim është një proces që zhvillohet gjatë gjithë vitit. Është bërë një analizë dhe parashikim për trajnimin e stafit të KKK-së dhe pikave të kontaktit/koordinatorëve kundër korrupsionit, për raportimin e SNKK.. Për këtë analizë është punuar së bashku me ekspertet e Projektit Twinning. Janë ndërtuar disa piketa të procesit të trajnimit, lidhur me kurrikulën, materialet trajnuese dhe skedulin e zhvillimit të trajnimeve. Është parashikuar të ketë një trajnim bazik të një mase të konsiderueshme të personave (75 përqind e FP të nominuar). Ky trajnim është parashikuar të zhvillohet për dy ditë. Është sugjeruar kryerja e trajnimit bazik dy herë në vit. Pas trajnimit të parë, është parashikuar gjithashtu të kryhet një raund vlerësimi (feedback) mbi përmbajtjen dhe përshtatjen e trajnimeve me nevojat e FP. Pas kësaj, mund të zhvillohen trajnime një ditore me tematika specifike.<br><br>Zhvillimi i kurseve të trajnimit të Focal Points është parashikuar të realizohet në tremujorin e parë të vitit 2019. |
| 4.06.e re3 | Trajnim i stafit. | *MD* | | | E realizuar | Në 15 maj 2018 u zhvillua një trajnim një ditor me stafin antikorrupsion në MD, me tematike: "Kontrolli i brendshëm, vlerësimi i riskut dhe planet e integritetit". Me pjesmarrje nga tre Drejtoritë, të cilat mbulojnë çështjet e antikorrupsionit, rreth 15 punonjës ndoqën trajnimin. Gjatë trajnimit u paraqitën modelet e tre linjave të mbrojtjes në organizatë dhe dallimet me tre grupet (ose linjat) të përfshira në menaxhimin efektiv të rrezikut. U paraqitën gjithashtu mënyrat e ndërtimit dhe çfarë përfshin portofoli i riskut dhe cikli i vlerësimit të riskut. U dhanë disa njohuri bazike mbi planet e integritetit. |

## Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.

| Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Institucioni përgjegjës | Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro) | Buxheti i alokuar për çdo aktivitet | Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2018 *(E realizuar/në proces/parealizuar)* | Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Objektivi 5: Përmirësimi i funksionimit të sistemit duke ofruar sisteme elektronike, procedura dhe facilitete moderne për zhvillimin e një bashkëpunimi të fortë ndërkombëtar.*** | | | | | | |
| **Aktivitet 5.01** | **Krijimi i një platforme të TI për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit.** | | | | | |
| 5.01.a | Krijimi i një qendre të përpunimit të të dhënave. | *(Institucioni për t`u caktuar nga KM) (AKSHI)* | | | Në proces | **Euralius:** EURALIUS, përveç asistencës që i ka dhënë MD-së për mirëmbajtjen e sistemit aktual ICMIS, ka filluar punën gjithashtu për hartimin e specifikimeve teknike për sistemin e ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Fillimisht do të fillohet me një projekt pilot, i cili do të përfshijë specifikimet e komponentëve kryesorë të softwareve.<br>MD ka krijuar një grup pune me përfaqësues edhe nga EURALIUS dhe JFA me qëllim analizën ligjore, gjendjen aktuale dhe diskutimin e konceptit mbi strukturat TI për gjyqësorin dhe prokurorinë në RSH. Ky proces do të çojë në hartimin e VKM-së për këto struktura, sikurse e kërkon parashikimi kushtetues dhe ai ligjor. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.01.b | Krijimi i rrjetit të një zone të gjerë të gjyqësorit (JustNET) (kosto operacionale). Krijimi i rrjetit të një zone të gjerë të gjyqësorit (JustNET). | *(Institucioni për t`u caktuar nga KM) (AKSHI)* | 100,000 | | E parealizuar | Nuk ka zhvillime për periudhën janar - dhjetor 2018. |
| 5.01.c | Sigurimi i pajisjeve të TI për përdoruesit fundorë (Just-net). | *(Institucioni për t`u caktuar nga KM) (AKSHI)* | | | E parealizuar | Në varësi të aktivitetit 5.01.b. |
| 5.01.d | Sigurimi i mirëmbajtjes së qendrës së të dhënave. | *(Institucioni për t`u caktuar nga KM) (AKSHI)* | 100,000 | | E parealizuar | Nuk ka zhvillime. Ky aktivitet është në varësi të aktiviteteve 5.01.a, 5.01.b dhe 5.01.c. |
| **Aktivitet 5.02** | **Përmirësimi i operacioneve të TI dhe shërbimeve mbështetëse për sistemet elektronike në gjyqësor (Krijimi i operacioneve të centralizuara TI dhe qendrës mbështetëse (ITOSC) që mbulojnë sistemet e TI të gjykatave, KLGj, KLP, HIC, dhe Këshillit të Emërimeve).** | | | | | |
| 5.02.a | Sigurimi i burimeve njerëzore. | *(Institucioni për t`u caktuar nga KM) (AKSHI)* | 67,676 | | Në proces | MD në muajin shkurt 2018 ka krijuar një grup pune me përfaqësues edhe nga EURALIUS dhe JFA me qëllim analizën ligjore, gjendjen aktuale dhe diskutimin e konceptit mbi strukturat TI për gjyqësorin dhe prokurorinë në RSH. Ky proces do të çojë në hartimin e VKM-së për këto struktura, sikurse e kërkon parashikimi kushtetues dhe ai ligjor.<br>Për periudhën janar-mars 2018 janë zhvilluar dy takime të grupit të punës së ngritur dhe aktualisht VKM është në proces hartimi.<br><br>Projekt-drafti si propozim i fundit nga EURALIUS dhe JFA, i është dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë në fund të muajit tetor 2018. Ky draft pas ri-shikimit të brendshem pritet të kalojë për konsultim. |
| 5.02.b | Sigurimi i mjedisit të punës (zyrë, pajisje hardware dhe software të TI për qendrën e kontrollit). | *(Institucioni për t`u caktuar nga KM) (AKSHI)* | | | E parealizuar | Nuk ka zhvillime për periudhën janar - dhjetor 2018. |
| 5.02.c | Trajnimi fillestar i personelit për sistemet elektronike (hartimi i kurrikulave dhe trajnim) Trajnimi vazhdues i personelit për sistemet elektronike. | *(Institucioni për t`u caktuar nga KM) (AKSHI)* | 15,000 | | E parealizuar | Nuk ka zhvillime për periudhën janar - dhjetor 2018. |
| **Aktivitet 5.03** | **Vendosja e sistemit të menaxhimit të çështjeve të gjykatave (ICMIS), në efiçencë të plotë.** | | | | | |
| 5.03.a | Specifikimi dhe projektimi funksional. | *KLGJ* | | | E parealizuar | Duke pasur parasysh që KLGJ u krijua vetëm në mesin e dhjetorit 2018, ende nuk është trajtuar vendosja në eficiencë të plotë e sistemit ICMIS që mbetet për t`u shqyrtuat gjatë vitit 2019.<br><br>Për vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të alokuar për këtë qëllim në fondin e menaxhuar nga KLD. |
| 5.03.b | Prokurimi i ICMIS dhe instalimi. | *KLGJ* | 1,250,000 | | E parealizuar | Për vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të alokuar për këtë qëllim në fondin e menaxhuar nga KLD. |
| 5.03.d | Migrimi i të dhënave nga sistemi aktual i menaxhimit të çështjeve te ICMIS. | *KLGJ* | 20,000 | | E parealizuar | Në varësi të aktivitetit 5.03.a dhe 5.3.b. |
| 5.03.f | Arritja e marrëveshjes së mirëmbajtjes për pajisjet e ICMIS (20% e vlerës së software). | *KLGJ* | | | E parealizuar | Në varësi të aktivitetit 5.03.a dhe 5.3.b. |
| **Aktivitet 5.04** | **Rritja e funksionalitetit të sistemit të menaxhimit të cështjeve të shërbimit të prokurorisë (CAMS) dhe përshtatja e tij me ndryshimet organizative të institucionit.** | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.04.a | Kryerja e përmirësimeve në sistemin CAMS. | *PP* | 100,000 | | Në proces | Gjatë vitit 2018 është bërë i mundur implementimi i modulit të përgjimeve, është përfunduar moduli i Prokurorisë së Përgjithshme dhe moduli i Apeleve dhe janë në fazë testimi.<br><br>Janë bërë përmirësime të akteve ligjore në formë elektronike.<br><br>Gjithashtu, vlen të përmendimin se është në testim moduli i statistikave.<br><br>Nga analiza përfundimtare e këtij sistemi nga ana e Drejtorisë IT në Prokurorinë e Përgjithshme, në raport me kërkesat e Kontratës, disa nga pikat e kësaj kontrate janë ende të papërmbushura dhe aktualisht kompania është duke punuar për finalizimin e tyre. Gjithashtu, kompania po riparon në bashkëpunim me departamentin e IT-së së prokurorisë defekte të ndryshme që lindin si pasojë e implementimeve që bëhen në sistemin CAMS.<br><br>Projekti është financim i BE dhe përmirësimet janë kryer në realizim të kësaj kontrate. |
| 5.04.b | Trajnimi i stafit. | *PP* | 10,000 | | Në proces | Pas testimit të të gjitha funksionaliteteve nga ana e grupit të punës, do të kryet një trajnim për stafin e IT-së mbi sistemin cams i programuar rreth 40 orë trajnim. Më pas stafi i IT-së do të trajnojë përdoruesit fundorë që janë Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore në të gjitha prokuroritë. |
| **Aktivitet 5.05** | **Rritja e efiçencës së procesimit të rasteve të Ndihmës Juridike Reciproke (NJR).** | | | | | |
| 5.05.a+b | Krijimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve për procesimin e çështjeve MLA me MeD (në vazhdim)./ Përfshirja e Prokurorisë së Përgjithshme në sistemin e mësipërm të menaxhimit të çështjeve. Costo përfshin 80,000 euro të financuara nga projekti LURIS | *MD, PP* | 100,000 | | E parealizuar | Për periudhën janar - dhjetor 2018 nuk ka zhvillime. |
| 5.05.c | Rritja e stafit me 3-5 të punësuar në MD. | *MD* | 36,000 | | E parealizuar | Është e varur nga aktiviteti 5.05 a+b. |
| 5.05.d | Punësimi i stafit shtesë në PP. | *PP* | 36,000 | | E parealizuar | Është e varur nga aktiviteti 5.05 a+b. |
| 5.05.e | Sigurimi i pajisjeve (skanera, printera, dhe fotokopje) në MD dhe PP. | *MD, PP* | | | E parealizuar | Është e varur nga aktiviteti 5.05 a+b. |
| 5.05.e re | Përmirësimi i përvitshëm. | *MD, PP* | 16,000 | | E parealizuar | Është e varur nga aktiviteti 5.05 a+b. |
| **Aktivitet 5.07** | **Përmirësimi i informacionit statistikor të dhënë nga sistemet e menaxhimit të çështjeve të gjykatave (krijimi i një shërbimi të integruar statistikor si një zgjidhje e përkohshme deri sa ICMIS të bëhet funksional.).** | | | | | |
| 5.07.a | Projektimi i nivelit të lartë dhe prova e konceptit. | *KLGJ* | | | E parealizuar | Duke pasur parasysh që KLGJ u krijua vetëm në mesin e dhjetorit 2018, ende nuk është trajtuar vendosja në eficiencë të plotë e sistemit ICMIS që mbetet për t`u shqyrtuar gjatë vitit 2019. |
| 5.07.b | Projektimi, zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të prodhimit | *(KLGJ)* | 100,000 | | E parealizuar | Për vitin 2018 nuk ka pasur buxhet të alokuar për këtë qëllim në fondin e menaxhuar nga KLD. |
| **Aktivitet 5.08** | **Krijimi i sistemit elektronik të publikimit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare.** | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.08.a | Përgatitja e një sistemi të integruar për publikimin e ligjeve të konsoliduara dhe akteve nënligjore të përmbledhjeve të legjislacionit sipas fushave. | *QPZ* | 200,000 | 14.000.000 lekë | Në proces | Lidhur kontrata nga AKSHI me operatorin ekonomik datë 14.6.2018 për krijimin e sistemit të QBZ-së. |
| 5.08.b | Popullimi i sistemit me aktet ekzistuese. | *QPZ* | | | Në proces | Popullimi me akte i faqes web është proces i përditshëm i botimit në Fletoren Zyrtare të akteve që sillen për botim. Menjëherë pas botimit të Fletores Zyrtare bëhet publikimi në kohë reale i akteve të ndara në faqen web të QBZ-së. Gjithashtu bëhet publikimi i akteve të përditësuara dhe i përmbledhëseve të legjislacionit. |
| 5.08.c | Publikimi i vendimeve gjyqësore. | *QPZ* | | | Në proces | Në Fletoren Zyrtare botohen vendimet të Gjykatës Kushtetuese, vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë si dhe vendime të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore për shpalljen të vdekur ose të zhdukur të personave. Gjithashtu publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare vendime të gjykatave për procedurat e falimentit. |
| **Aktivitet 5.09** | **Rritja e efikasitetit të funksionimit të përmbaruesve në përputhje me standardet moderne europiane.** | | | | | |
| 5.09.b | Përmirësimi i ndërlidhjeve ndërmjet ALBIS dhe sistemeve të tjera elektronike të gjyqësorit. | *MD, Përmbarimi* | 0 | | Në proces | Zgjidhja e re software është gati për t`u implentuar pasi është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 416 datë 04.07.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në Nr. 443. datë 16.06.2011 "Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit të administrimit të ndërveprimit për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik ALBIS". Sistemi ALBIS është në fazën e mirëmbajtjes. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit janë hapur userat dhe janë shpërndarë seti i dokumenteve (manualet e përdorimit së bashku me kredencialet). |
| **Aktivitet 5.11** | **Përmirësimi i funksionimit të sistemit të vuajtjes së dënimit duke siguruar sistemet e nevojshme të teknologjisë deri brenda vitit 2020.** | | | | | |
| 5.11.c | Projektimi i bazave të të dhënave (sistemi i Cards) ndërmjet IEVPve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. | *MD* | 1,250,000 | | E parealizuar | Ky aktivitet duhet rishikuar pasi DPB ka në përdorim sistemin e kartelave të të denuarve (MISP). Sistemi CARDS nuk disponohet nga DPB. |
| **Aktivitet 5.12** | **Përmirësimi i kushteve të punës sipas standardeve moderne të PP dhe zyrave të prokurorive në qytete.** | | | | | |
| 5.12.0 | Realizimi i vlerësimit të nevojave (me prioritizim) dhe i studimit të fizibilitet si dhe kostim për rindërtim/ndërtim të godinave të reja. | *PP* | | | Në proces | Në vitin 2016, është analizuar nevoja për ndërtimin e tre godinave të reja ne prokuroritë Durrës, Tiranë e Vlorë.<br>Këto investime (me vlere 15 milion euro) synohet të bëhen me donatorë të huaj.<br>Gjatë periudhës raportuese, ka nisur procesi i diskutimeve për gjetjen e sheshit të ndërtimit.<br><br>Ky projekt u përditësua në kuadër të rishikimit të paketës kombëtare të projekteve strategjike. |
| **Aktivitet 5.13** | **Përmirësimi i kushteve të punës sipas standardeve moderne të gjykatave (nëpërmjet ndërtimit të godinave të reja për gjykatat më poshtë):** | | | | | |
| 5.13.0 | Realizimi i vlerësimit të nevojave (me prioritizim) dhe i studimit të fizibilitet si dhe kostim për rindërtim/ndërtim të godinave të reja. | *(KLGJ) ZABGJ* | | | E parealizuar | **ZABGJ:** Studime fizibiliteti për gjykatat nuk janë bërë, pasi kjo lidhej me miratimin e hartës së re gjyqësore. Përmbushja e këtij aktiviteti, përpara ndryshimeve të pritshme në riorganizimin e gjykatave, do të rezultonte joeficiente. Ligji nr.115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", neni 84, përcakton se miratimi i hartës së re gjyqësore është kompetencë e KLGJ-së. Ky institucion u krijua në datë 12 dhjetor 2018.<br><br>**KLGJ** do të trajtojë me përparësi çështjen e përmirësimit të kushteve të punës në gjykata, edhe në kuadër të rishikimit të hartës gjyqësore. Për t`u realizuar në vitet në vijim. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.13.e re | Përmirësimi i infrastrukurës ndërtimore në gjykata. | *(KLGJ) ZABGJ* | | 26.000.000 lekë[9] | E realizuar | **ZABGJ:** Rikonstruksioni i plotë i godinës së Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë përfundoi. Godina e rikonstruktuar garanton ambjentet e punës për stafin, si dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore; përmirësimin e standardeve të tjera që lidhen me aksesueshmërinë e PAK, ofrimin e shërbimit cilësor e transparent për publikun në ambjent të posacëm për këtë qëllim, etj. Vlera e plotë e investimit ishte rreth 106 milion lekë. Për vitin 2016 është likujduar një vlerë prej 32 milion lekë; ndërsa për vitin 2017 kjo vlerë është rreth 48 milion lekë. Për vitin 2018 është likujduar fondi rreth 26 milion lekë. Gjatë muajit shtator përfundoi kolaudimi i punimeve dhe marrja në dorëzim e godinës. Gjykata zhvillon aktivitetin e saj në godinën e rikonstruktuar. |
| **Aktivitet 5.14** | **Ngritja e efektivitetit të hetimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rritja e efektivitetit dhe decentralizimit të përgjimeve** | | | | | |
| 5.14.c | Hartimi i specifikimeve teknike për pajisjen e përgjimit<br>Blerja e pajisjeve të nevojshme (një njësi qëndrore për SPAK)<br>Mirëmbajtja e pajisjes. | *PP* | 1,500,000<br>100,000 | | E realizuar për PP | Raportimi për vitin 2017 jep detaje për kontratën e blerjes dhe koston.<br>Ndërkohë në muajin qershor 2018, në kuadër të rishikimit të paktës kombëtare të projekteve strategjike PP ka identifikuar nevojën për mbështetje për decentralizimin e përgjimeve. |
| 5.14.d | Ndërtimi i kapaciteteve. | *PP* | | | E realizuar | Janë organizuar 4 trajnime, ku pjesëmarrës kanë qenë oficerë të policisë gjyqësore të drejtorisë së përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme.<br>Shkolla e Magjistratures ka zhvilluar disa aktivitete për prokurorët me tema si: Përgjimi si mjet për kërkimin e provës në procesin penal; teknikat e posacme te hetimit; hetimet proaktive.<br>Në muajin Korrik në DPPSH është organizuar një aktivitet për përgjimin taktik (IMCI CATCHER), ku kanë qenë oficerë të policisë gjyqësore të drejtorisë së përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të prokurorisë Tiranë. (pa kosto) |

## Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

| Aktiviteti | Përshkrimi i Aktivitetit | Institucioni përgjegjës | Kosto e vlerësuar e produktit (në Euro) | Buxheti i alokuar për çdo aktivitet | Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2018 *(E realizuar/në proces/parealizuar)* | Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2018 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Objektivi 6: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.*** | | | | | | |
| **Aktivitet 6.01** | **Rritja e mundësisë për punësimin e të burgosurve dhe ofrimin e programeve të edukimit / programeve të aftësive jetësore sipas standardeve evropiane të praktikave më të mira.** | | | | | |

[9] Vlera e likujduar është rreth 26 milion lekë ose rreth 210,663 euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë datë 31/12/2018 (1€=123,42 lekë).

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.01.d | Ofrimi i kurseve në aftësitë bazë dhe ato teknike. | *MD, DPB* | 10,000 | 103.500 lekë ( E paparashikuar në PBA) | E realizuar | Në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi kanë bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional për zhvillimin e procesit të formimit profesional në IEVP. Në zbatim të kësaj marrëveshje, procesi i formimit profesional është zhvilluar mbështetur në kërkesat e të burgosurve, hapësirat fizike dhe bazën materiale që disponojnë disa institucione, si dhe llojet e kurseve profesionale që ofrohen nga DRFP. Si rezultat, për periudhën Janar-Dhjetor 2018, kurset profesionale të ofruara janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 272 të burgosur. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka hartuar një projekt VKM e cila i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për procedurat në vijim, për shpërblimin e punës së të burgosurve. Projekt VKM-ja "Për nxitjen e punësimit dhe shpërblimin për punën e të dënuarve dhe të paraburgosurve" do të krijojë mundësi për lidhje produktive me tregun e punës dhe punëdhënësit, si dhe një shpërblim të drejtë për punën e kryer, për t'iu dhënë të burgosurve mundësi më të mira të zhvillimit të aftësive të tyre, të cilat përputhen me këtë treg.<br><br>Projektet po implementohen në përputhje me objektivat e Ministrisë të Drejtësisë për forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve dhe forcimin e reformës për zhvillimin e politikave të arsimit e formimit profesional dhe punësimit për shtetasit me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve, duke i bashkërenduar ato me politikat kombëtare.<br><br>Organikat e punës për të paraburgosurit dhe të dënuarit për periudhën Janar-Dhjetor 2018 kanë pasur një numër prej mesatarisht 649 personash të punësuar në muaj nga të cilët 144 të paraburgosur dhe 505 të dënuar. |
| 6.01.e | Ofrimi i programeve edukuese kundër recidivizmit. | *MD, DPB* | 10,000 | 103.500 lekë (E paparashikuar në PBA) | E realizuar | Shtetasit e burgosur në prag lirimi trajtohen me programe specifike për këtë kategori me qëllim reduktimin e recidivizmit. Objektivat e programeve për të burgosurit në prag lirimi kanë të bëjnë me aftësimin e të burgosurve për të përballuar me jetesën pas kryerjes së dënimit dhe shmangien apo reduktimin e recidivizmit. Stafi social në IEVP-të kryen trajnimin e kësaj kategorie në drejtim të përvetësimit të disa shprehive sociale, aftësive bazë për tu përballur me tregun e punës, forcimin e lidhjeve me të afërmit dhe komunitetin, si dhe referimin e rasteve pa përkrahje sociale pranë institucioneve përkatëse shtetërore. Për periudhën Janar-Dhjetor 2018 këto programe janë ofruar për rreth 210 shtetas të burgosur në muaj. |
| 6.01.f | Ofrimi i programeve edukuese kundër përdorimit të drogave. | *MD, DPB* | 20,000 | 103.500 lekë (E paparashikuar në PBA) | E realizuar | Për periudhën Janar-Dhjetor 2018 stafi social në IEVP-të ka trajtuar me programin për ish përdoruesit e lëndëve narkotike rreth 315 të burgosur ish përdorues të lëndëve narkotike, nga të cilët rreth 66 persona trajtohen paralelisht me terapi medikamentoze nga stafi mjekësor në bashkëpunim me Aksion Plus. Ky program synon stabilizimin e gjendjes psiko-emocionale në kushtet e privimit nga liria dhe ka si objektiv afatgjatë rehabilitimin e tyre. Personave të trajtuar ju ofrohet asistencë nga një ekip multidisiplinar ku përfshihet kryesisht këshillim psikologjik dhe në raste të veçanta terapi medikamentoze me metadon sipas shkallës së abuzimit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.01.g | Ofrimi i programeve të tjera edukative. | *MD, DPB* | 20,000 | 103.500 lekë (E paparashikuar në PBA) | E realizuar | Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 procesi mësimor formal u zhvillua në 8 institucione: IEVP Vlorë, Lezhë, Korçë, Rrogozhinë, Kavajë, Fushë-Krujë, Korçë dhe Peqin. Numri i personave të regjistruar për vitin akademik 2017-2018 në IEVP ishte 222 shtetas të privuar nga liria. Për vitin akademik 2018-2019 *deri më tani* janë regjistruar 162 shtetas të privuar nga liria. Me qëllim rregullimin e mënyrës së realizimit të procesit arsimor është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit e Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Drejtësisë me nr. 526 prot., datë 17/01/2018. Kjo marrëveshje ka qëllim kryesor realizimin e të drejtës kushtetuese të të paraburgosurve dhe të dënuarve për kryerjen e arsimit me kohë të plotë ose me kohë të pjeshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br><br>Numri i aktiviteteve rehabilituese të organizuara *mesatarisht në muaj* gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 me të dënuarit/të paraburgosurit në IEVP është 457. Numri mesatar i të burgosurve që ndoqën aktivitetet kulturore e sportive *në muaj* në institucion është 3740. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 në IEVP janë zhvilluar nga Sektorët e Kujdesit Social mesatarisht 210 tema sociale *në muaj*, ku kanë marrë pjesë mesatarisht 2900 të burgosur *në muaj*. |
| **Aktivitet 6.02** | **Reduktimi i mbipopullimit në burgje dhe paraburgim sipas standardeve evropiane.** | | | | | |
| 6.02.e re | Blerja e 30 makinave ambulancë. | *MD, DPB* | 1,350,000 | 24.000.000 | Në proces | Me fonde të buxhetit të shtetit u realizua kontrata e blerjes së automjeteve për sektorin e forcave operacionale, duke ndikuar në përmirësimin e sigurisë së lëvizjes dhe transferimit të burgosurve. DPB realizoi blerjen e 4 automjeteve të reja (autoburgje) me standarde të larta për realizimin e transferimeve/ shoqërimeve të burgosurve nga IEVP-të në gjykata dhe lëvizjet brenda sistemit të burgjeve. Gjithashtu, me fondin e vënë në dispozicion për riparimin e mjeteve janë riparuar 20 automjete nga të cilat rreth 8 prej tyre janë në shërbim të administratës së DPB-së dhe 12 për forcat operacionale, mjete që mbulojnë lëvizjen e të dënuarve në të gjithë IEVP-të sipas nevojave të tyre. |
| **Aktivitet 6.03** | **Garantimi i mbrojtjes së të drejtave themelore të ndaluarve me probleme të shëndetit mendor.** | | | | | |
| 6.03.b | Ndërtimi i një ndërtese të re të përshtatshme për trajtimin e të ndaluarve me probleme të shëndetit mendor. | *MD* | 4,000,000 | 62.629.000 (Rikonstruksion në IEVP Lezhë) | Në proces | Deri në përfundimin e procedurave për ndërtimin e një institucioni të veçantë për trajtimin e të sëmurëve mendor me masë mjekësore mjekim i detyruar, DPB ka planifikuar disa masa afatshkurtra me qëllim përmirësimin e situatës aktuale të trajtimit të kësaj kategorie në sistemin e burgjeve. Më vënien në funksion të burgut të ri në Shkodër dhe transferimin e të dënuarve të godinave 4,5 në IEVP Lezhë, po realizohet përshtatja e ambienteve të IEVP Lezhë në mjedise spitalore, në të cilën do të akomodohen shtetasit me masë mjekësore mjekim i detyruar. Kapaciteti aktual i godinave nr. 4 dhe 5 të IEVP Lezhë është 280 vende. Pra, lirohen në Lezhë 280 vende, si rrjedhojë e transferimit të dy godinave, 4, 5 në Shkodër dhe sistemohen 279 shtetas me masë mjekësore mjekim i detyruar. |
| 6.03.c | Promovimi i bashkë punimit ndër-institucional për trajtimin e kësaj kategorie. | *MD* | | | Në proces | Me urdhër nr.504, datë 15/01/2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve është miratuar një plan masash për zbatimin e rekomandimeve të CPT-së në kuadër të vizitës së tyre të kryer në Shkurt 2018. Ndër masat e planifikuara është edhe forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për trajtimin e kategorisë së personave me probleme të shëndetit mendor. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.03.d | Bashkëpunimi me OJF që ndajnë praktikat e mira dhe të suksesshme për trajtimin e kësaj kategorie në përputhje me standardet evropiane. | *MD, DPB* | | | E realizuar | Gjatë periudhës Janar-Dhjetor2018 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka vijuar bashkëpunimin me organizata jo fitimprurëse që zbatojnë projektet në sistemin e burgjeve. Një ndër fushat e bashkëpunimit ka qenë dhe përmirësimi i praktikave të trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor në burgje. Këtu vlen për tu përmendur bashkëpunimi me Këshillin e Europës në drejtim të trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor dhe risk për suicid. Në funksion të këtij bashkëpunimi u ngrit një grup pune me përfaqësues të DPB dhe institucioneve të varësisë me qëllim hartimin e një manuali për trajtimin e kësaj kategorie. Në përbërje të grupit të punës kanë qenë psikologë dhe mjekë të sistemit të burgjeve të udhëhequr nga ekspertë të huaj të fushës, të përzgjedhur nga Këshilli i Europës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi në muajin Prill 2018 është organizuar një vizitë studimore në shërbimin e burgjeve në Irlandë për shkëmbimin e eksperiencave dhe implementimin e praktikave më të mira në sistemin tonë penitenciar në disa nivele. Gjatë kësaj vizite në fokus ishte edhe trajtimi i kategorisë së personave me probleme të shëndetit mendor. |
| **Aktivitet 6.05** | **Përmirësimi i nivelit të burimeve njerëzore të alokuara për rehabilitimin e të burgosurve.** | | | | | |
| 6.05.a | Ndryshimi i skemës së pagave për stafin e ri mjeksor. | *MD* | | | E parealizuar | Nga DPB i është propozuar Ministrisë së Drejtësisë përmirësimi i skemës së pagave të punonjësve të shëndetësisë në sistemin e burgjeve sipas nivelit të pagave në shërbimin civil. Duhet theksuar se pagat e ulëta të mjekëve në sistemin e burgjeve krijojnë edhe më shumë vështirësi për punësimin e tyre në institucionet penitenciare. Është e nevojshme rritja e kategorisë së pagës për stafin mjekësor në sistemin e burgjeve, duke marrë në konsideratë edhe vështirësitë e punës. Me shkresën nr. 10983/2 Prot., datë 16.01.2018 është përcjellë shqetësimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me pagat e mjekëve në sistemin e burgjeve. Në këtë shkresë është kërkuar ndërhyrja e Ministrisë së Shëndetësisë mbi klasifikimin e pagave të mjekëve në sistemin e burgjeve me atë të mjekëve të familjes në zonat shumë të thella malore për shëndetin publik. |
| 6.05.c | Programet e trajnimit për stafin e ri civil. | *DPB* | | 177.000<br>(E paparashikuar në PBA) | E realizuar | Sektori i Trajnimeve në DPB ka zhvilluar trajnime bazë për stafin e rekrutuar rishtas. Për periudhën Janar-Dhjetor 2018 janë përfshirë në këto trajnime 1689 punonjës. Për realizimin e trajnimeve sa më profesionale dhe të frytshme për grupin e synuar është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Sigurisë, e cila ka ofruar ambientetet dhe burime njerëzore për realizimin dhe mbarëvajtjen e trajnimeve. Janë në proces rishikimi kurrikulat e trajnimit. Për rishikimin e tyre është ngritur një grup ekspertësh nga D.P.Burgjeve të cilët janë asistuar nga ekspertë ndërkombëtarë të Këshillit të Europës. |
| **Aktivitet 6.06** | **Forcimi dhe përmirësimi i shërbimit të provës sipas standardeve moderne evropiane.** | | | | | |
| 6.06.a | Rritja e nr të të punësuarve dhe llojshmërisë së aftësive në shërbimin e provës. | *MD, Shërbimi i Provës* | | | E parealizuar | Nuk ka zhvillime për periudhën janar-dhjetor 2018. |
